


UDHËZUES I SHKURTËR PËR TEORITË E KONSPIRACIONIT



Projekti "Mendim Kritik për Qytetarët me Shkathtësi Mediatike - KriThink" zbatohet nga Metamorphosis dhe EuroThink. Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian.



METAMORPHOSIS
Foundation for sustainable ICT solutions



Titulli original:

Кус водич за теории на заговори

Botues:

Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - Metamorfozis
rr. Apostoll Gusllarot, nr.40, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
www.metamorphosis.org.mk | info@metamorphosis.org.mk

tel / faks: +389 2 3109 325

Për botuesin:

Bardhyl Jashari

Autore:

Dr. Biljana Gjoneska (Д-р Билјана Ѓонеска)

Shënim: Autorja është bashkëpunëtore shkencore në ASHAM dhe përfaqësuese kombëtare për projektin evropian "Analiza krahasuese e teorive të konspiracionit" (conspiracytheories.eu).

Menaxher i projektit:

Filip Stojanovski

Kolegjiumi redaktues:

Bardhyl Jashari, Filip Stojanovski,
Vladimir Petreski, Elida Zylbeari

Përkthyer nga maqedonishtja ne shqip:

Drilon Saliu

Ilustrimet:

Biljana Gjoneska

Dizajni:

Biljana Nedelkovska

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

327.88:159.955(036)
32.019.5:159.955(036)
327.88:[616.98:578.834(036)
316.642.3:[616.98:578.834(036)

GJONESKA, Biljana
Udhëzues i shkurtër për teoritë e konspiracionit [Електронски извор] / [autore Biljana Gjoneska;
Ilustrimet Biljana Gjoneska ; përkthyer nga maqedonishtja ne shqip Drilon Saliu]. - Shkup: Metamorfozis, 2021

Начин на пристапување (URL):
<https://metamorphosis.org.mk/wp-content/uploads/2021/10/udhezues-i-shkurter-perteorite-e-konspiracionit-2.pdf>

Превод на делото: Кус водич за теории на заговори. - Текст во PDF Формат, содржи 51 стр., илустр.-
Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 05.07.2021. - Библиографија: стр. 48-51

ISBN 978-608-263-089-2

а) Теории на заговор - Разобличување - Критичко мислење - Водичи
б) Теории на заговор - Ковид-19 - Водичи

COBISS.MK-ID 55092229

Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit “Mendim kritik për qytetarët me aftësi mediatike - KriThink”, të cilin e zbatojnë Fondacioni Metamorfozis dhe Eurothink me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.

Përmbajtjet e “KriThink” mund të shkarkohen falas në përputhje me kushtet e licencës Creative Commons – thekso burimin, nëse theksohet burimi dhe vendoset linku deri te qendra e burimeve në internet crithink.mk. Përmbajtjet jo gjithmonë i pasqyrojnë pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJE

Hyrje	5
Shëtitje e shkurtër në botën e teorive konspirative	7
Skena e konspiracioneve si skenë krimi	10
Konspiracioni gjendet në syrin e vëzhguesit.....	13
Teoria e konspiracionit si burg i padukshëm	16
Teoritë e konspiracionit: Justifikim i mirë, kërkim i përgjigjes ose përpjekje për bisedë?	19
Teori të rrezikshme të konspiracionit	22
Teoritë konspirative me përmasa pandemike	26
Vaksinimi informativ.....	30
Lidhja e vërtetë me teoritë e konspiracionit.....	33
Shembuj të demaskimit të teorive të konspiracionit me verifikim të fakteve	37
Burimet	46



HYRJE

Publikimi “Udhëzues i shkurtër për teoritë e konspiracionit” bazohet në doracakun për edukim joformal për shkathtësi mediatike “Me mendim kritik për ekspozimin e dezinformatave,” i botuar më herët në kuadër të projektit “Mendim kritik për qytetarë me shkathtësi mediatike - KriThink”, të cilin Fondacionit Metamorfozis dhe Eurothink e zbatojnë me mbështetje të Bashkimit Evropian. Doracakun shërben si material edukativ kyç për forcimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile, medimeve dhe një rrethi më të gjerë qytetarësh për t’u përballur me manipulimin e mediave.

Publikimi i këtij udhëzuesi i përgjigjet nevojës shoqërore për përballje dhe trajtim të fenomenit të teorive konspirative si një formë specifike e dezinformimit dhe manipulimit të mediave, që është provuar jashtëzakonisht e dëmshme gjatë pandemisë së Covid-19, duke e zvogëluar besimin në sistemin shëndetësor, e që ndikon drejtpërdrejt edhe në efikasitetin e masave mbrojtëse. Në vitin 2020, hulumtimi i “KriThink” “Pandemi apo Infodemi? Mendimi kritik dhe teoritë e konspiracionit gjatë pandemisë “ treguan se narrativë alternative, veçanërisht teoritë e konspiracionit të lidhura me pandeminë, janë jashtëzakonisht të përhapura në mesin e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, jo vetëm për shkak të politizimit të tyre, por edhe sepse bazohen në skepticizmin racional që e kanë grupe të caktuara njerëzish. Në vend të trajtimit patologjik që e rrit polarizimin ekzistues, nevojiten programe që synojnë adresimin e faktorëve të strukturuar që çojnë në përhapjen e teorive të konspiracionit. Njohuritë dhe përvojat e paraqitura përmes këtij udhëzuesi, janë një kontribut në rritjen e të kuptuarit të këtyre gjendjeve si nga publiku i gjerë, ashtu edhe ai profesional, që është baza për rritjen e rezistencës ndaj ndikimeve dhe manipulimeve të dëmshme, si në nivelin personal, ashtu edhe në atë shoqëror.

**Bardhyl Jashari, Drejtor Ekzekutiv,
Fondacioni për Internet dhe Shoqëri “Metamorfozis”**

* * *

Dezinformatat zakonisht janë pjesë e një narrativi. Teoritë e konspiracionit shkojnë edhe më tej. Ato përfaqësojnë largim të organizuar dhe të strukturuar nga e vërteta, një mashtrim më gjithëpërfshirës sesa vetë dezinformimi, e disa madje krijojnë narrative të rreme dhe shërbejnë si bazë për cikle të reja dezinformimi për vite me radhë, dekada, e madje edhe shekuj në të ardhmen. Narrativi konspirativ antisemitik për Rothschild-ët, të cilët gjoja sundojnë botën përmes sistemit bankar dhe trashëgimtarët e të cilëve gjoja ende po i tërheqin disi fjetet e fuqisë globale nga prapavija, ishte krijuar 150 vjet më parë dhe ende shërben si bazë apo rast për teoritë e reja konspirative, të cilat në bazë e kanë të njëjtin tregim.



Teoritë e konspiracionit i përfshijnë ato dezinformata, gënjeshtër, manipulime, gjysmë të vërteta, si dhe ndonjë informacion të vërteta të rastit, të cilat i plotësojnë nevojat e storjes së konspiracionit dhe thurin murale të paraqitjeve të rreme të realitetit. Ato krijojnë një njollë dyshimi, e cila më pas me dezinformata, gjysmë-informata dhe manipulime shtesë përhapet dhe e mbulojnë tapiserinë e të vërtetave, vlerave qytetëruese, standardeve etike dhe morale dhe besimeve, që e përbëjnë qenien e viktimës, duke i korruptuar mendjet dhe karakteret ashtu siç teoritë e konspiracionit bëhen pjesë gjithnjë e më e madhe e diskursit digjital publik.

Duke pasur parasysh numrin e madh të gënjeshtërave që i përmbajnë në vete, teoritë e konspiracionit nuk është e vështirë të demaskohen. Pothuajse të gjitha teoritë historike të konspiracionit janë demaskuar prej kohësh. Por, përkundër kësaj, ato ende kanë aftësinë të mashtrojnë audiencë të mëdha, e madje ndodh që edhe viktimat e mashtruar të bëhen ithtarë dhe zëdhënës të teorisë së konspiracionit me të cilën janë mashtruar më herët. E të mos flasim për faktin që vazhdimisht krijohen teori të reja të konspiracionit.

Për shkak të gjithë kësaj, lufta kundër tyre duhet të zhvillohet në të gjitha nivelet dhe me përdorimin e të gjitha mjeteve të komunikimit. Nëse hiqet një, më së shumti dy letra nga «themelet» e një kulle prej letrave, të quajtur teori e konspiracionit, ajo shembet plotësisht. Por shpesh e vërteta në vete dhe e thënë vetëm një ose dy herë nuk mjafton. Në një situatë të tillë, duhet të ndërmarrim iniciativë dhe t'i demaskojmë këto kulla prej letrave vazhdimisht. Të tregojmë se tregimet e tilla janë të palogjikshme, absurde dhe të pamundshme, dhe të cilat rregullisht, nën sipërfaqe ndeshen me realitetin dhe faktet. Po ashtu, është e nevojshme të mësojmë sa më shumë të jetë e mundur për audiencën me të cilën kemi të bëjmë, cilat janë besimet dhe frika e tyre, si dhe arsyet e besimit të tyre në teoritë e konspiracionit. Në këtë mënyrë do t'i njohim aktorët jo-autentikë nga «besimtarët» e vërtetë dhe do të jemi në gjendje t'i përdorim mjetet më efektive në luftën për të vërtetën.

Ka mënyra për të fituar kundër teorive të konspiracionit. Ato duhet të zbatohen me mençuri, vetëm pasi të jetë gjetur më efektivja. Dhe atëherë duhet të vërshtojmë kanalet e komunikimit publik me të vërtetën dhe ta promovojmë atë sa më shpesh që të mundemi.

Ky udhëzues ju mundëson që shpejt të futeni në botën e teorive të konspiracionit, t'i njihni karakteristikat e tyre, t'i vëreni segmentet dhe pjesë përbërëse të teorive të tilla, të mësoni si t'i dalloni ato dhe shërben si ndihmë për betejat e mëtejshme me këtë lloj specifik të gënjeshtërave dhe manipulimeve të strukturuar, aftësia e të cilave për t'u shkaktuar dëm atyre që besojnë në to, por edhe institucioneve, politikave publike, si dhe segmenteve të tëra të jetës shoqërore, nuk duhet të nënvlerësohen.

Vladimir Petreski,

Redaktor i përmbajtjeve në gjuhën maqedonase

Qendra e burimeve online

“Mendim kritik për qytetarë me aftësi mediatike – KriThink”



SHËTITJE E SHKURTËR NË BOTËN E TEORIVE KONSPIRATIVE

Ky tekst është konceptuar si një shëtitje nëpër një botë plot konspiracione, e shikuar përmes syve të atyre që besojnë në teoritë e konspiracionit. Ne duhet ta njohim atë dhe të mësojmë si ta dallojmë, sepse tek secili prej nesh ekziston një besues i tillë, ndërsa tërësia e rrethanave të jashtme lehtë mund t'i zgjojë këto dobësi dhe prirje tona.

“Bota është përplot me komplotistë”.

Kjo deklaratë ka kuptim kur hiqet nga një kornizë konkrete dhe përgjithësohet, sepse bota drejtohet vërtet nga idetë dhe konspiracionistët e tyre, domethënë nga njerëzit që janë mbrojtës të pikëpamjeve, parimeve, vlerave. Nga ana tjetër, nëse deklarata fillestare do të ishte futur në thonjëza dhe do të shtohet në një kontekst specifik, atëherë do të tingëllonte si një citim apo parullë. Më saktësisht, do të ishte motoja më e shkurtër e njerëzve me një mentalitet konspirativ, sepse ata kanë një tendencë të fortë për të besuar se *bota drejtohet nga ngjarje, të cilat drejtohen fshehurazi nga konspiracionistë, të paraqitur si grupe ose individë të zgjedhur, të bashkuar me qëllime të këqija.*

Ky është përshkrimi i parë, më i shkurtër dhe më konciz i teorive të konspiracionit deri më tani. Nga ana tjetër, përshkrimi i zgjeruar është zhvendosur në këtë tekst dhe paraqitet si një shëtitje në botën e kompleteve. Është një botë e parë me sytë e besuesve në teoritë e konspiracionit, sepse te secili prej nesh ekziston një besues i tillë, kështu që në rrethana të caktuara, këto dobësi dhe prirje tonat mund të zgjohen.

PËR KUPTIMIN E FJALËVE

Në botën e konspiracioneve nuk ka asnjë teori konspirative, por konspiracion në praktikë, mirëpo në mungesë të provave praktike dhe të prekshme. Në fakt, në këtë botë, etiketa “teori konspirative” perceptohet si një përpjekje për të denigruar, mohuar ose fshehur komplotin e vërtetë. Për më tepër, për njerëzit që janë më të prirur të besojnë në teoritë e konspiracionit, ky karakterizim është një lloj sinjali për një sulm tinëzar dhe për t'i minuar përpjekjet e tyre për t'i demaskuar dhe zbardhur konspiracionet e vërteta.

Në përgjithësi, termi “teori konspirative” mund të duket problematik për shumicën e njerëzve, pavarësisht nga prirja e tyre për të (mos) besuar në teoritë e konspiracionit. Para së gjithash, fjala “teori” në shkencë i referohet një sistemi njohurish që vërtetohet shkencërisht, domethënë është një e vërtetë objektive. Nga ana tjetër, në jetën e përditshme, fjala “teori” zakonisht i referohet një kuptimi që është e kundërta, domethënë njohurisë që është spekulative dhe e pakonfirmuar. Këtu ndodh një



paradoks interesant. Për ata që besojnë në teori konspirative, ajo është pothuajse identike me një teori shkencore, sepse identifikohet me të vërtetën objektive dhe të padiskutueshme (sipas sistemit të tyre të vlerave, besimeve dhe njohurive). Për të tjerët, teoria e konspiracionit kuptohet në mënyrë bisedore si një nga shumë teoritë që është një version i mundshëm, por i pakonfirmuar dhe i pamundur i realitetit. Përveç kësaj, fjala “konspiracion” në praktikë zakonisht i referohet një interpretimi të ngjarjeve dhe personaliteteve që mbështetet në mënyrë konsensuale nga shumica. Në të kundërt, fjala “konspiracion” në teori (të komplotit) i referohet një pikëpamjeje të poseduar ekskluzivisht nga “të zgjedhurit”. Është një interpretim alternativ, i cili nuk korrespondon me opinionin popullor. Sepse, në botën e kompleteve, ato, si rregull, nuk zbulohen dhe nuk rezonojnë si skandale në skenën kryesore. Përkundrazi, ato mbeten të fshehura në prapaskenë dhe zhvillohen mënjanë. Kjo është arsyeja pse e vërteta nuk duhet kërkuar në skenë, por në prapavijë.



Foto. 1: Domethënia dhe përkufizimi i fjalëve “teori” dhe “konspiracion”

Për shkak të të gjitha këtyre kontradiktave dhe mospërputhjeve, termi “teori konspirative” në psikologji përcaktohet kryesisht nga përmbajtja (si një rrëfim i fshehtë i dikujt për dëm) dhe më pak nga forma (si një interpretim që është më pak i mundshëm dhe i besueshëm sesa alternativat). Më në fund, disa teori konspirative më vonë bëhen të njohura si konspiracione të vërteta, dhe disa konspiracione të zbardhura, ndonjëherë duken më joreale se shumë teori konspirative. Prandaj, vërtetësia nuk duhet të jetë kriteri i vetëm ose kryesor në përcaktimin e teorive të konspiracionit.



RRETH PORTRETIT TË BOTËS

Bota e konspiracioneve është një version i thjeshtuar i realitetit, dhe mund të pikturohet në dy ngjyra: e zezë dhe e bardhë. Në veçanti, kjo botë shihet përmes prizmit të forcave të së mirës dhe të së keqes, kështu që është një vend i rrezikshëm dhe kërcënues, ku të zgjedhurit janë në konflikt dhe luftë të vazhdueshme me forcat e bashkuara të së keqes. Në një version të kësaj bote, teoricienët e konspiracionit janë si heronj epikë, me fuqi të pazakontë, drejtësi dhe vërtetësi, por edhe me një prirje për të luftuar dhe vepruar, kështu që ata vazhdimisht rezistojnë, kundërshtojnë dhe demaskojnë konspiracione.

Një pamje tjetër më e thjeshtë e botës plot konspiracione është një botë me dy anë: e sipërme dhe e poshtme. Ky është një vend i padrejtë ku mbretëron ligji i të fuqishmit, eprorit dhe më të fortit. Në këtë version të botës, teoricienët e konspiracionit janë viktimat të pafajshme, të manipuluar edhe të shfrytëzuar nga shtypës me qëllime të këqija.

PËR RREGULLAT E PASHKRUARA

Secili version i realitetit të thjeshtuar drejtohet nga disa rregulla të thjeshta: ndarja (dualiteti), lidhshmëria e qëllimshme dhe fshehtësia. Me të vërtetë është një botë në të cilën gjërat janë ose të mira ose të këqija, gjërat nuk janë të rastësishme dhe asgjë nuk është siç duket. (foto. 2).



Foto. 2: Karakteristikat kryesore të botës së kompleteve: a) gjithçka është e mirë ose e keqe b) asgjë nuk është e rastësishme c) asgjë nuk është siç duket

Sidoqoftë, tipari më impresionues i kësaj bote është antropocentrizmi, domethënë përqendrimi i saj te njerëzit, posaçërisht te qëllimkëqinjët e rrezikshëm ose heronjtë e guximshëm, të cilët janë drejtuesit kryesorë të të gjitha konspiracioneve dhe fabulave, të gjitha kompleteve dhe shpalosjeve. Në një nivel të simbolikës dhe alegorisë, teoritë e konspiracionit janë si përrallat e të rriturve. Ato janë përvoja të fillimit dhe mekanizma (de)kompensues, të cilët ofrojnë mundësinë për të përjetuar fatkeqësi të ndryshme (kriza shoqërore dhe katastrofa natyrore), duke ua atribuar atyre parashikimin, shqyrtimin dhe përshtatshmërinë e ngjarjeve që mund të kenë qenë rezultat i një rastësie të pastër. Kështu, për ata që besojnë në to, teoritë e konspiracionit e rivendosin kuptimin, rendin dhe parashikueshmërinë, duke e vendosur iluzionin e kontrollit mbi kaosin dhe shansin.



SKENA E KONSPIRACIONEVE SI SKENË KRIMI

Bota e konspiracioneve është bardh e zi sepse është plot kontraste drastike dhe kontradikta dramatike. Konfliktet dhe kundërshtimet e tyre hedhin hije, të cilat shfaqen mbi jetët e zakonshme, duke futur pasiguri të tensionuar në pritje të ngjarjeve kataklizmike me një efekt shkatërrues mbi individët. Këto ngjarje, të vendosura në epiqendrën e tronditjes së sistemit, janë rezultat i teorive të konspiracionit. Le të hedhim një vështrim nga afër, duke parë “skenen e komplotit” si një lloj “skene krimi” e parë përsëri përmes “syrit detektiv” të atyre që u besojnë teorive të konspiracionit.

“Çdo teori e konspiracionit dallohet me skenar të caktuar.”

Kjo deklaratë vlen për disa “skeptikë” (të cilët kanë tendencë të njohin dhe të refuzojnë teoritë e konspiracionit), por gjithashtu edhe për të ashtuquajturit “besimtarë” (të cilët kanë një ndjeshmëri të theksuar ndaj teorive të konspiracionit). Për të parët, peizazhi buron nga atmosfera e krijimit të filmit, plot ekzagjerim dhe teatralitet dramatik të lartpërmendur. Të dytët, duke besuar se asgjë nuk është ashtu siç duket, e perceptojnë pamjen si skenë dhe koreografi, ku gjithçka është e parashikuar, e llogaritur, e rregulluar paraprakisht dhe e orkestruar plotësisht. Kështu, besuesit e teorive të konspiracionit i qasen fazës së konspiracionit si një skenë krimi.



INFORMIM NGA “SKENA E KONSPIRACIONIT”

Në këtë skenë, të gjitha “dëshmitë” e shpërndara ndiqen me një sy vigjilent dhe elementet “në dukje të palidhura” janë të lidhura, dhe pastaj vendosen në një “sistem më të madh vlerash”. Sepse teoritë e konspiracionit zakonisht karakterizohen nga një lidhje dhe ndërthurje e përgjithshme e ngjarjeve dhe personaliteteve, por edhe integrimi në teoritë e tjera të konspiracionit. Për dallim nga këto, komplotet e vërteta zakonisht mbesin të kufizuara në vende dhe rrethana të caktuara, supozime dhe personalitete të caktuara.

Më pas, si “dëshmi” trajtohen të gjitha deklaratat, madje edhe ato që janë të kundërta, të ashtuquajtura pretendime që reciprokisht mohojnë njëra tjetrën. Kushti i vetëm është që ato të posedojnë elemente konspiracioni. Për shembull, pohimi se vdekja e Princeshës Diana është e rreme dhe e inskenuar, fiton shkallën e njëjtë të rëndësisë sa pretendimi se vdekja e Princeshës Diana është e vërtetë, por e porositur dhe e planifikuar.

Përveç kohezionit të përgjithshëm, monolitizmit dhe përpjekjes për unitet, disa teori konspirative gjithashtu kanë efektin e pasqyrës. Kështu, bashkimi i fshehtë dhe komunikimet e koduara të kryera me qëllim dëmtimi në të ardhmen, që zakonisht u atribuohen grupeve ose individëve të fuqishëm, rriten në një mënyrë organizimi dhe veprimi për disa anëtarë të lëvizjeve radikale dhe besimtarë në teoritë e rrezikshme të konspiracionit. Pikëpamjet ekstreme, të përforcuara nga narracionet konspirative, shpesh prodhojnë modele të lidhjes dhe të planifikimit të paligjshëm. Kjo ilustronet më mirë nga shembulli i QAnon, një teori konspiracioni e favorizuar nga lëvizjet e ekstremitetit të djathtë bazuar në besimin se bota drejtohet nga një rrjet satanistësh dhe pedofilësh liberalë që tregtojnë me njerëz (fëmijë dhe gra), duke e minuar stabilitetin e familjes si themel i vlerave amerikane. Së pari, kjo teori karakterizohet nga misteri dhe bashkimi i fshehtë, sepse udhëheqësit e saj dhe pasuesit e tyre komunikojnë me pseudonime, të mbuluar me anonimitet dhe krejtësisht të panjohur për publikun. Së dyti, mesazhet e publikuara dhe të diskutuara janë enigmatike, me dy kuptime ose të paqarta, kështu që ato duken si udhëzime të koduara. Në fund, kjo teori ka nxitur me të vërtetë një aleancë të dëmshme që arriti kulmin në sulmin e janarit ndaj Senatit të SHBA-ve, me viktima njerëzore dhe dëme materiale që janë të padiskutueshme dhe reale.

“QASJA DETEKTIVE” E TEORICIENËVE TË KONSPIRACIONIT

Si janë të bindur të gjithë “detektivët” e vetëshpallur dhe teoricienët e konspiracionit se ata kanë një depërtim të veçantë, mprehtësi dhe aftësi për të parë përtej të tjerëve dhe më thellë se paraqitja sipërfaqësore e gjërave. Në parim është një sistem besimi i bazuar në zëvendësimin e tezave dhe besimeve të shtrembëruara (Foto 3).

Kështu, skepticizmi i tepërt paraqitet si një dozë e shëndetshme e kujdesit dhe dyshimit. Por, ndryshe nga dyshimi i zakonshëm, dyshimi dhe mosbesimi i konspiracionit nuk karakterizohen me analitikë dhe nuk drejtohen nga kurioziteti për të gjetur të vërtetën objektive. Skepticizmi i tepërt shpesh paraqitet si të qenit mendjehapur, gjegjësisht si liri nga kufizimet dhe censura e shoqërisë. Përsëri, kjo mendje e hapur e deklaruar bie ndesh me rezistencën e pazakontë ndaj pikëpamjeve të reja dhe provave konkrete që nuk i mbështesin tezat e supozuara. Përkundrazi, çdo përpjekje për të hedhur poshtë dhe mohuar teoritë e konspiracionit ka efektin e kundërt tek besimtarët e teorive, pasi



MËNYRA TË TË MENDUARIT	
KONVENCIONALE (e zakonishme)	KONSPIRATIVE (konspirative)
QËNDRIMI NDAJ DËSHMIVE TË OFRUARA	
NDJESHMËRI (pirrja për të ndryshuar mendje)	REZISTENCË (kokëfortësi dhe inat)
PËRPUNIM I INFORMACIONEVE	
DOZË E SHËNDOSHË SKEPTICIZMIT (kureshtje dhe analitikë)	SKEPTICIZËM I THEKSUAR (dyshim dhe mosbesimi)
NXJERRJA E PËRFUNDIMEVE	
E BAZUAR NË KOHERENCË (lidhje shkakësore dhe logjike)	E BAZUAR NË KUNDËRSHTIME (jokonsekuente dhe kundërthënëse)
SHTJELLIM I VËRTETË	TEORI KONSPIRATIVE

Foto. 3: Dallimet midis të menduarit konvencional dhe konspirativ

rezulton në përforcimin dhe vendosmërinë e tyre të mëtejshme. Rezultati përfundimtar është një sistem jo koherent i besimeve, i bazuar në teza që kundërshtojnë dhe përjashtojnë njëra-tjetrën, lidhje që nuk ndërtohen as logjikisht dhe as lidhen nga shkak dhe pasoja, dhe përfundime që nuk mund të realizohen logjikisht dhe as nuk duhen pritur. Prandaj është e rëndësishme që të nxjerrim në pah këto ndryshime midis të menduarit konspirativ dhe atij konvencional, si një mënyrë për të orientuar dhe njohur shpejt sistemet e bindjeve konspirative.



KONSPIRACIONI GJENDET NË SYRIN E VËZHguesIT


3

Konspiruesi është një njeri që e vëzhgon botën e jashtme me një “sy të brendshëm” dhe rrethanat i vlerëson “me sy”. Ai nuk i vlerëson ato “nga koka te këmbët” dhe as nuk i “mat dy herë” para se të gjykojë. Ai është një vëzhgues intuitiv i botës dhe nxjerr përfundime duke u bazuar në instiktin dhe bindjet e tij.

“Secili konspiracion është prodhim i imagjinatës.

Kjo deklaratë vlen si për konspiracionet reale ashtu edhe për ato të pretenduara. Në konspiracionet e realizuara, imagjinata vihet në funksion të krijimit të planeve të reja, duke dalë me ide të pazakonta, qasje dhe bashkime të pazakonta. Në teoritë e konspiracionit, nga ana tjetër, ajo është një reflektim i ëndrrave, ideve dhe fantazive të dikujt.

Nga ana tjetër, konspiracioni gjendet në syrin e shikuesit.



Sepse ai është një njeri që e vëzhgon botën e jashtme me një “sy të brendshëm” dhe e vlerëson “me sy”. Ai beson se e ndjek “mendjen e shëndoshë”, por nuk mendon “me kokë të ftohtë”. Dhe kjo është arsyeja pse nuk vlerëson “me masë” por “përafërsisht” dhe “me shumicë”. Në të vërtetë, konspiracioni drejtohet nga fotografia e madhe dhe ndjenjat, jo nga detajet dhe mendimi. Përshtypja e parë është më e rëndësishmja për të dhe ai lëviz në bazë të impulsit më të vogël. Reagimi i tij është refleksiv, automatik dhe instiktiv, dhe logjika e tij është thellësisht intuitive. Përfundimisht, interpretimi i tij i imazhit të botës është intuitiv, kështu që të kuptuarit e tij për gjërat bëhet konspirativ. Në një farë mase, të gjithë e kemi këtë tendencë dhe në rrethana të caktuara priremi të jemi sipërfaqësor dhe iluziv. Sepse intuita është e nxituar, sjell kënaqësi të çastit dhe përmbush.




Foto 4: Stilet njohëse - të menduarit intuitiv kundrejt atij analitik

Përkundër tendencës për të menduarit intuitiv, qëndron analitika (foto 4). Ajo nuk vjen spontanisht, as nuk duket e natyrshme. Përkundrazi, ajo duket e imponuar sepse kërkon përpjekje dhe këmbëngulje. Ndonjëherë është e dhimbshme dhe e mundimshme, sepse është afatgjatë dhe nuk heq dorë në rast të pengës së parë. As nuk kënaqet me përshtypjen e parë. Është esenciale, e përqendruar dhe insiston për saktësi dhe precizitet. Megjithatë, megjithë përpjekjen dhe rraskapitjen, qasja analitike duket se është mburoja më e mirë kundër teorive të konspiracionit.

Për më tepër, **qasja analitike** e plotësuar me **mendimin kritik** (gjegjesisht gatishmëria për t'i rishikuar gjërat dhe të qenit i hapur për azhurnimin e vazhdueshëm të njohurive, por edhe për t'i plotësuar qëndrimet), dhe e zgjeruar me **qasje shkencore** (gjegjesisht udhëheqja sipas parimeve të hulumtimit shkencor që bazohet në krahasime dhe



supozime, por edhe verifikime të bazuara në fakte), janë paralajmërues të besueshëm të fitores në luftën kundër dezinformimit. Sepse është një luftë që së pari e luftojmë me veten dhe dobësitë tona. Dhe kjo së pari me bindjen e verbër ndaj ndjenjave, dhe pastaj nënshtrimi i fjalëve që kanë një ngarkesë emocionale dhe morale. Këto fjalë mund të jenë sensacionale dhe mashtruese, sepse ato shërbejnë për të përcjellë emocione, por edhe një lloj gjykimi vlerash. Njerëzit i përdorin fjalët e tilla kur duan të tregojnë epërsi morale, por edhe të shprehin dënimin moral dhe zemërimin ndaj dikujt. Nga ana tjetër, grupet dhe mediat mund t'i përdorin ato për qëllime manipulimi, në mënyrë që të irritojnë audiencën dhe të shkaktojnë përçarje. Në rrethana të tilla, emocionaliteti bëhet një barrë për racionalitetin e marrësit, ndërsa ndjenjat e shtuara hapin derën për një larmi paragjykimesh. Për shembull, theksohet tendenca për nxjerrje të shpejtë të përfundimeve ose për të bërë gjykime në bazë të preferencave.

Është interesante se te njerëzit me prirje për teori konspirative, mund të ketë një prirje të theksuar për perceptimin iluzor të skemave dhe modeleve. Për shembull, nëse ata do të përballeshin me një art abstrakt ose me imazhe me një rregullim të rastësishëm të konturave, teoricienët e konspiracionit do të tregonin një tendencë për të parë kuptime të fshehura dhe për të njohur forma të reja. Për më tepër, ato mund të karakterizohen nga të menduarit magjik, domethënë, besimi në bestytni se mendimet në nënvetëdije dhe ndjenjat e ndrydhura mund të ndikojnë disi në ngjarjet e jashtme dhe të kontrollojnë mundësitë.

Me këtë ndërlidhen botëkuptimet jokonvencionale dhe hapja ndaj stileve alternative siç janë: besimet në fenomenet paranormale, okultizmi (misterioz dhe i mbinatyrshëm), animizmi (atribuimi i vetëdijes dhe shpirtit tek objektet dhe materiet jo të gjalla), pseudoshkenca dhe ezoterizmi, madje edhe në fanatizmi fetar. Duket se të gjitha këto shfaqje të besimit në të mbinatyrshmen reflektohen vetëm në pasqyrën e dëshirës për epërsi mbi natyrën e pafavorshme. Konkretisht, nevoja për kontroll dhe mbizotërim mbi ngjarjet kanalizohet si një besim në “superfuqi” të ndryshme duke filluar nga “skanimi” i ngjarjeve, përmes “lidhjes detektive” në ngjarjet, deri te “lëvizja telepatike” e tyre me ndihmën e të menduarit magjik.

Por, fuqia më e madhe megjithatë qëndron te dija. Sepse njerëzit që duan të mësojnë, gjejnë vazhdimisht mënyra për të përmirësuar njohuritë dhe arsimimin e tyre, dhe kështu bëhen rezistentë ndaj teorive të konspiracionit, por të hapur ndaj së vërtetës. Në të njëjtën kohë, ata mbeten kureshtarë dhe të mahnitur nga magjia e botës, të cilën e zbulojnë çdo ditë përmes bukurive të shkencës.




4 TEORIA E KONSPIRACIONIT SI BURG I PADUKSHËM

Fasadë e fuqisë dhe superioritetit, por një ndjenjë e ngulitur thellë e inferioritetit. Mosbesimi ndaj të tjerëve dhe armiqësia ndaj sistemit, si shprehje e pasigurisë dhe e papajtueshmërisë me to. Ky është një grup i tipareve që mund ta joshin një individ në sistemet e mbyllura të besimit.

“Besimi në teoritë e konspiracionit i ngre muret e burgjeve të padukshme.”

Kjo deklaratë është e vlefshme edhe kur teoritë e konspiracionit kuptohen si sisteme të përgjithshme të besimeve, por edhe kur ato konsiderohen si besime individuale dhe personale. Nëse vendosen në një kornizë më të gjerë konceptuale, besimet në teoritë e konspiracionit të kujtojnë sisteme “të forta” ideologjike ose fetare. Ato karakterizohen nga hermetizmi e madje edhe nga dogmatizmi, sepse faktorë të ndryshëm që zakonisht lidhen me të njëjtin qëllim të përbashkët, por me arsye të ndryshme, kanë rezultat të ngjashëm. Por, edhe kur analiza ngushtohet në interpretime dhe bindje personale, besimet në teoritë e konspiracionit përsëri japin përshtypjen e ngurtësisë dhe klaustrofobisë. Ato janë në favor të egos, por e robërojnë shpirtin. Konkretisht, ato janë një lloj burgu për botëkuptimin, kështu që megjithëse sjellin lehtësim të përkohshëm, ato mund të jenë pengesë për rritjen shpirtërore dhe zhvillimin afatgjatë të atij që u beson. Të përshtatura



për egon, ato ofrojnë narrative të mëdha dhe të zgjerueshme me karakter grandoman dhe narcizist. Sidoqoftë, krahasuar me zhvillimet objektive dhe të mundshme, teoritë e konspiracionit mbeten interpretime mjaft të ngushta dhe të kufizuara të ngjarjeve përreth.

Vetëdijësimi dhe vetëbesimi i theksuar janë arsye e mundshme pse disa njerëz e shohin veten si qendra e vëmendjes së padëshiruar të njerëzve të tjerë dhe viktime të kompleteve të dikujt tjetër. Për më tepër, të armatosur me nevojë për veçanti, këta njerëz besojnë se ata janë të pajisur me një aftësi të pazakontë për të parë përtej sipërfaqes dhe iluzionit, drejt e në sfond dhe në thelb, dhe për të hedhur dritë mbi teoritë e konspiracionit (si pretendime që çdoherë duhet të zbardhin qendrat e margjinës dhe imazhet në prapavijë). Dallimi midis atyre që besojnë në teoritë e konspiracionit dhe atyre që dyshojnë, buron nga vlerësimi për diapazonin e vizionit të vëzhguesit. Për besuesit në teoritë e konspiracionit, kjo pikëpamje të çon përtej asaj që duket dhe që shfaqet. Për pjesën tjetër, teoritë e konspiracionit janë një pamje që shfaqin vetëm sipërfaqen pa hyrë në thelb, domethënë ato japin një pamje të thjeshtuar të rrethanave përreth.

Është interesante se nevoja e theksuar për të qenë të veçantë nga të tjerët lind nga krahasimi i vazhdueshëm me ta dhe shqetësimi nga mendimi i rrethit. Si me çdo bukuri të dhunshme, fasada e bukur e këtyre njerëzve shërben për të mbuluar vetëbesimin e tyre të prekshëm dhe qëndrueshmërinë e thërrmuar të karakterit të tyre. Në të vërtetë, hulumtimet sugjerojnë se vetëvlerësimi i ulët shpesh shoqërohet me një prirje më të lartë për të besuar në teoritë e konspiracionit. Ato janë mënyrë për të shmangur përgjegjësinë dhe përballjen me realitetin, për ta zhvendosur fajin tek sistemi dhe rrethi, por edhe për të ruajtur imazhin e vetes përpara botës. Tregimi i fajtorëve dhe ekspozimi i komplotistëve kujdestarë është një tipar i zakonshëm i njerëzve me konspiracion të theksuar. Kështu, duket se ndjenjat negative ndaj vetes, të cilat janë shtypur për një kohë të gjatë, gjejnë një mënyrë për të dalë në dritë, dhe për t'u derdhur dhe projektuar përreth. Mosbesimi ndaj individëve intensifikohet kur ata janë përfaqësues të elitave, d.m.th. politike, fetare, industriale dhe të tjera të fuqishme. Dyshimi në vlerat morale të disa individëve të përzgjedhur gjithashtu mund të shkaktojë dyshime në efikasitetin e sistemit, funksionalitetin e rregullimeve shoqërore dhe normat dhe rregulloret shoqërore. Si rezultat i kësaj, ndjenja e përgjithshme e pakënaqësisë, braktisjes dhe e refuzimit të sistemit nganjëherë rritet, dhe në raste ekstreme ka armiqtësi të hapur, e madje edhe përpjekje për grusht shteti të organizuar (siç ishte rasti me sulmin e janarit në Senatin e SHBA-ve).

Në përgjithësi, tek njerëzit me **paqëndrueshmëri të theksuar emocionale**, të prirë për stres dhe nervozizëm, të shoqëruar me frikë dhe ankth ("*high neuroticism*"), ose **kënaqësi të zvogëluar**, gjegjësisht bashkëpunim të ulët dhe mospërshtatje ndaj rrethanave ("*low agreeableness*"), ekziston besim më i fortë në **interpretimet alternative dhe teoritë e konspiracionit**. Pikërisht këto dy tipare të pesë dimensioneve të mëdha të personalitetit ("*Big Five*") i intensifikojnë emocionet negative, i paralizojnë proceset e mendimit dhe e zvogëlojnë aftësinë për të menduar në mënyrë kritike dhe analitike (siç është theksuar në një artikull të mëparshëm edukativ). Të nxitur nga këto vëzhgime, disa studiuues kanë argumentuar se njerëzit me variante të dekompensuara, anormale dhe keqadaptim të tipareve të personalitetit mund të tregojnë prirje të fortë për teoritë e konspiracionit. Për shembull, teoritë e konspiracionit do të ishin karakteristike për njerëzit me dyshim të theksuar (që do të çonte në skizotipi dhe paranojë), ose ekscentricitet të tepruar (i cili do të çonte në psikotizëm). Sidoqoftë, konsensusi i përgjithshëm shkencor është se **duhet**



shmangur barazimi i prirjes ndaj teorive të konspiracionit me çrregullimet mendore dhe sëmundjet mendore. Gjegjësisht, nëse boshtin “shëndet-sëmundje” e imagjinojmë si kontinuum, atëherë sëmundja mendore do të vendoset në skajet e kësaj drejtëze të pandërprerë, ndërsa shkallët e ndryshme të besimit në teoritë e konspiracionit do të shpërndahen përgjatë gjithë gjatësisë së saj. Në të vërtetë, pothuajse çdo person të paktën një herë në jetën e tij do të shprehë besimin në të paktën një teori konspirative. Prandaj, është moralisht dhe etikisht jo korrekte të stigmatizohen dhe të demonizohen njerëzit që kanë shprehur mbështetje për pretendimet që u ngjajnë teorive të konspiracionit. Për më tepër, si çdo tallje dhe etiketim i fshehtë, edhe kjo qasje është joproduktive dhe nuk çon në avancim real. Vetëm një qasje e moderuar dhe empatike, plot dëshirë për mirëkuptim të ndërsjellë do të çonte në ndryshime pozitive shoqërore.




TEORITË E KONSPIRACIONIT: JUSTIFIKIM I MIRË, KËRKIM I PËRGGJIGJES OSE PËRPPJEKJE PËR BISEDË?

5

Narrativët e konspiracionit presupozojnë kompleksitet, por në fakt janë të thjeshta. Nga rrjeti i ngjeshur i ngjarjeve dhe individëve, zakonisht dalin modele dhe shembuj të parashikueshëm: individë të fuqishëm ose grupe individësh të fuqishëm, zakonisht identifikohen si njerëz të fshehtë dashakeqës dhe fajtorë kryesorë. Nga ana tjetër, motivet për të besuar në teoritë e konspiracionit duken të parashikueshme, por ato janë komplekse. Ato shërbejnë për të përmbushur një larmi nevojash: për mbijetesë, për depërtim dhe njohje ose përkatësi (shoqërim).

“Teoritë e konspiracionit janë shërbëtor të shumë zotërinjve.”

Kjo deklaratë mbështetet në disa nivele. Niveli më sipërfaqësor përfshin dy kategori njerëzish: ata që i prodhojnë (mund të besojnë, por nuk është e thënë), dhe njerëzit që besojnë pa rezerva në to (mund t'i prodhojnë teoritë, por nuk është e thënë). Në duart e



grupit të parë, teoria e konspiracionit bëhet një mjet për përhapjen e dezinformatave dhe kryerjen e manipulimeve të ndryshme. Në mendjet e grupit të dytë, teoria e konspiracionit bëhet mekanizëm për zgjidhjen e nevojave urgjente dhe thelbësore: për mbrojtje dhe siguri (në mjedis); informim dhe njohuri (për rrethanat); integrim (në komunitet) dhe vetëbesim (në veten e tyre). Prandaj, në grupin e dytë të njerëzve, teoritë e konspiracionit shërbejnë si justifikim i mirë për aspiratën e zgjuar për mbijetesë dhe vazhdimin e llojit, ose si mënyrë për të përmbushur nevojën për përgjigje (p.sh. njohja dhe mbijetesë), ose si mënyrë për të forcuar marrëdhënien, për të mbajtur narrativin dhe bisedat me grupin (gjegjësisht shoqërim)



Foto 5: Motivet për të besuar në teoritë e konspiracionit

Nevojat ekzistenciale (thelbësore) lindin nga synimi i njeriut për të sunduar me rrethanat. Ato janë të lidhura me dëshirën për të vendosur rend, siguri dhe stabilitet dhe kontroll mbi mjedisin. Ato rrezikohen në kushtet e katastrofave natyrore (të tilla si përmytjet ose tërmetet) dhe krizat shoqërore (për shembull, konfliktet ushtarake, krizat e refugjatëve ose pandemitë) të përmasave të mëdha, të cilat paraqesin një kërcënim për jetën e njeriut. Në kushte të tilla, teoritë e konspiracionit sigurojnë rregullim të shpejtë dhe afatshkurtër të stresit të papritur, por edhe kompensim afatgjatë për emocionet negative (frikë, ankth, fobi) të akumuluar pas ngjarjeve të përjetuara. Në kohë fatkeqësish dhe krizash, njerëzit u drejtohen teorive të konspiracionit për t'i shpëtuar mendimit se janë lënë në mëshirën e fatit, të rrethanave të ndërlikuara të shoqërisë, ose tekave të natyrës.

Nevojat epistemologjike (njohëse) lindin nga përpjekja e vazhdueshme për të kuptuar rrethanat. Ato kanë të bëjnë me dëshirën njerëzore për një përfaqësim objektiv dhe koherent të botës me pasqyrim të saktë të rrethanave. Ata kërcënohen nga ngjarje që janë të shoqëruara me papritshmëri dhe jo-transparencë (p.sh. incidente shoqërore dhe skandale politike). Mungesa e informacionit për të gjitha ngjarjet, si dhe pasqyra jo e plotë e rrethanave që i paraprinë, krijojnë klimë për teoritë e konspiracionit. Në kushte të tilla, teoritë e konspiracionit shërbejnë për të mbuluar “boshllëqet” në ngjarjet pasuese, dhe mospërputhjet në argumente. Ato janë narrative të mëdha që korrespondojnë me ngjarjet e mëdha, kështu që e rikthejnë kuptimin e botës, si dhe ndjenjën e orientimit dhe njohjes së rrethanave. Për shembull, vdekja e papritur e një personi të rëndësishëm nuk është kurrë e rastësishme, dhe teoria konspirative për montimin e rastit, shërben për të “justifikuar” humbjen e papritur, por edhe për të “rimenduar” ose për t'i “shpjeguar” dhe “për t'i dhënë kuptim” rrethanës fatkeqe.



Nevojat shoqërore (sociale) lindin nga aspiratat njerëzore për përkatësi dhe integrim në grup, të cilin ai e dëshiron dhe me të cilin identifikohet. Këto nevoja rrezikohen kur lidhja me grupin ose statusi i tij vihet në dyshim. Në rastin e parë, teoritë e konspiracionit janë mekanizma kohezivë që i forcojnë lidhjet me anëtarët e tjerë të grupit, pasi ato synojnë grupe ose individë të jashtëm. Në rastin e dytë, teoritë e konspiracionit janë mekanizma mbrojtës që e ruajnë statusin e grupit në sytë e anëtarëve, pasi i portretizojnë ata si viktima të pafajshme, heronj të cilëve u është bërë e padrejtë dhe martirë.

Megjithëse motivet për të besuar në teoritë e konspiracionit duken intuitive, të natyrshme, të kuptueshme dhe madje të pritshme, shfaqja e tyre nuk është gjithmonë e justifikuar. Kjo është veçanërisht e vërtetë për rrëfimet që përdoren si justifikime të vazhdueshme dhe vazhdojnë në planin afatgjatë si forca regresive që kufizojnë dhe bllokojnë zhvillimin e individit. Për më tepër, teoritë e konspiracionit që paraqesin rrezik për të tjerët (p.sh, kur synojnë individë dhe grupe “të jashtëm”) ose mjedisin (p.sh, teoritë e konspiracionit që e mohojnë shkencën) duhet të monitorohen nga afër. Prandaj, duke adresuar motivet e shfaqjes së tyre, ne kemi mundësinë të kuptojmë rrënjët e tyre, të njohim filizat e parë dhe të pengojmë degët e rrezikshme të teorive të dëmshme të konspiracionit.



TEORI TË RREZIKSHME TË KONSPIRACIONIT

Në themelin e çdo konspiracioni është vendosur rreziku i ndonjë kërcënimi, por edhe mundësia reale e realizimit të tij. Në teoritë e dëmshme të konspiracionit, ky kërcënim mund të shërbejë si një shtysë fillestare për fillimin e mobilizimit dhe organizimit masiv, i cili do të çonte në një sekuençë shkatërruese të ngjarjeve me pasoja të dëmshme dhe të paparashikueshme.

“Rreziku nga një “konspiracion” varet drejtpërdrejt nga dobësia e “zotërve” të tyre”.

Kjo deklaratë vlen njësoj si për konspiracionet e planifikuara (d.m.th. praktike) ashtu edhe për ato të supozuara (d.m.th. teorike). Gjegjësisht, në themel të çdo konspiracioni janë ngulitur dy elemente: **paralajmërimi fatkeq** dhe **mundësia reale për realizimin e saj**. Konspiracionet e vërteta bëhen të fuqishme kur “zotrat” e tyre janë moralisht dhe etikisht “të pafuqishëm”, gjegjësisht kur konspiratorët janë të paaftë për marrëveshje transparente dhe konsensuale. Nga ana tjetër, teoritë e konspiracionit fitojnë fuqi shkatërruese kur mbështeten dhe drejtohen nga personazhe të “dobët”, gjegjësisht kur konspiratorët kërkojnë strehim në rrëfime të thjeshta dhe rrëfime “bardh e zi”, për ngjarje komplekse me shumë paqartësi dhe “zona gri”.



Megjithatë, grupimet fillestare të motivuara nga narrativat e ngacmimeve mund të jenë naive dhe disi të dobishme për individin, madje edhe konstruktive nga ana shoqërore. Për shembull, ato mund të sigurojnë ndjenjë të përkatësisë dhe të bashkimit për ata që ndihen të marginalizuar dhe se u është bërë e padrejtë. Nga ana tjetër, shoqërimi mund t'u japë zë atyre që nuk janë të zëshëm dhe të inkurajojë debate dhe dialogje politike. Në rastin më të mirë, disa teori konspirative për të zbuluar komplotet e pretenduara mund të kontribuojnë me të vërtetë në rritjen e përgjegjësisë së autoriteteve dhe përfaqësuesve të sistemit. Në raste të tjera, teoritë e konspiracionit mbeten neutrale, gjegjësisht nuk kanë forcë shtytëse për ndryshime shoqërore. Përballë tyre, ekziston një grup i teorive të rrezikshme të konspiracionit, sepse ato shërbejnë si shtysë fillestare për mobilizim për veprime të dëmshme me pasoja të paparashikueshme (fig 6). Më poshtë është një përmbledhje e efekteve anësore të teorive të konspiracionit mbi marrëdhëniet ndërpersonale, rrethanat politike dhe shëndetin e qytetarëve (fig.7).




Foto. 6: Ndarja e teorive të konspiracionit sipas marrëdhënies me realitetin dhe rrezikut të pasojave

SHOQËRIA

Ekspozimi ndaj teorive të rrezikshme të konspiracionit mund të nxisë ndjenja të pasigurisë dhe të zhgënjimit me sistemin, si dhe mosbesim dhe armiqësi të hapur ndaj përfaqësuesve të tij. Kjo mund të reflektohet në marrëdhëniet e ngushta ndërpersonale, si dhe në marrëdhëniet me miqtë dhe familjen (veçanërisht ata që nuk e mbështesin të njëjtën narrativë). Marrëdhëniet me të afërmit mund të vuajnë dhe gjithë familja mund të shkatërrohet nën barrën e qëndrimeve të ndryshme. Kjo vjen nga fakti se besimi në



disa teori të rrezikshme konspirative mund të jetë e vështirë të çrrënjohet, veçanërisht kur ato i kompensojnë nevojat emocionale ose janë të lidhura ngushtë me besimet fetare dhe ideologjike të besimtarit.

POLITIKA

Teoritë e konspiracionit që shërbejnë si “strehë” për ata që u është bërë e padrejtë, ose si “justifikim” për ndikimin e humbur shoqëror, mund të çojnë në apati politike. Për shembull, ngurrimi dhe dorëheqja në radhët e mbështetësve të partive që i kanë humbur zgjedhjet politike, mund të rezultojë në pjesëmarrje të zvogëluar në zgjedhjet e ardhshme. Në favor të kësaj janë edhe rezultatet e një hulumtimi vendor, i cili tregoi se pjesëmarrja në referendum në vitin 2018 u zvogëlua (ndërsa mbështetja për teoritë e konspiracionit kundër BE-së u rrit), tek mbështetësit e opsionit politik që i humbi zgjedhjet e mëparshme parlamentare në vitin 2017.

Nga ana tjetër, disa teori armiqësore konspirative mund t'i radikalizojnë mbështetësit dhe besimtarët e tyre, t'i prishin marrëdhëniet me grupet dhe individët e targetuar, dhe të kontribuojnë në polarizimin e shoqërisë. Në të vërtetë, hulumtimet tregojnë se ithtarët e opsioneve politike të ekstremit të majtë dhe të ekstremit të djathtë kanë prirje më të theksuar për të besuar në teoritë e konspiracionit, ku në rolin e konspiratorëve paraqiten grupe të ndryshme (p.sh. tek e majta ekstreme ata janë përfaqësuesit e elitave kapitaliste, dhe tek e djathta ekstreme mund të jetë anëtarë të feve dhe etnive të tjera). Në këtë kuptim, teoritë e konspiracionit shërbejnë si “shumëzues të radikalizimit” dhe përforcues të formacioneve ekstremiste.

Në fund të fundit, besimi në teori të rrezikshme konspirative mund të jetë një faktor i drejtpërdrejtë rreziku për përshkallëzimin e krimit, dhunës dhe konfliktit të armatosur. Arsyet mund të jenë të ndryshme si: largimi nga puna dhe përgjegjësia morale (për shkak të zhgënjimit me sistemin dhe përfaqësuesit e tij) ose intoleranca dhe armiqësia e hapur ndaj njerëzve (të cilët janë viktimat e teorive të konspiracionit).

SHKENCA

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet atyre teorive të konspiracionit që i mohojnë faktet e pamohueshme shkencore në lidhje me shëndetin e njeriut. Rreziku nga ndryshimet klimatike dhe sëmundjet infektive me koronavirusin e ri janë problemet më të rëndësishme dhe teoritë e konspiracionit që i mohojnë ato, çojnë në rritje të dyshimit, pasigurisë, hezitimit, dyshimit, mohimit, rezistencës dhe madje kundërshtimit të drejtpërdrejtë të masave për t'i zbutur ose zgjidhur ato. Pandemia e Covid-19 është problemi më urgjent i njerëzimit dhe sjellja e njeriut është çelësi i suksesit. Në kushtet e vaksinës së gjetur dhe trajtimeve ekzistuese për t'i mbështetur të sëmurët, fati i njerëzimit ende varet nga aftësia individuale e secilit prej nesh, për ta parë gënjeshtren me një sy kritik, por edhe për ta parë drejt në sy të vërtetën. Dhe në përgjithësi, aftësia për të njohur rrëfime të rrezikshme konspirative, si dhe për të parashikuar pasoja të padëshiruara të gjera është një fuqi të cilën duhet të përpiqemi ta forcojmë, pasi ajo është mburojë kundër grackave të përditshme, streseve dhe ngjarjeve të pafavorshme.






Foto 7: Pasojat e dëmshme të teorive të rrezikshme të konspiracionit në: marrëdhëniet ndërpersonale, rrethanat politike dhe shëndetin e qytetarëve




TEORITË KONSPIRATIVE ME PËRMASA PANDEMIKE

Pandemia aktuale, e cila është karakterizuar me përhapje të koronavirusit të ri në të gjithë botën, shoqërohet gjithashtu nga një infodemi, gjegjësisht me vërshim të (dez) informatave. Një lidhje e përbashkët e dy fenomeneve janë teoritë e konspiracionit mjekësor. Në këtë rast, ato janë të lidhura me Kovid-19 dhe zënë një pjesë të konsiderueshme të hapësirës së komunikimit. Siç pritej, në kushte të pandemisë, teoritë e konspiracionit marrin përmasa pandemike. Versione të ndryshme shumohen, përhapen në të gjithë popullsinë dhe hyjnë në jetën tonë të përditshme. Së bashku me numrin në rritje të mbështetësve (të cilët në kushte pandemike kërkojnë përgjigje), rritet edhe numri i konspiratorëve të theksuar (sepse në kushtet e infodemisë çdokush mund të jetë subjekt i teorive të konspiracionit).

“Të besosh në teoritë e konspiracionit është si të praktikosh një fe imagjinare.”

Kjo deklaratë vlen si për individët, ashtu edhe për komunitetin. Pavarësisht nga numri i mbështetësve, teoritë e konspiracionit të kujtojnë fetë e reja që kanë zëvendësuar perënditë abstrakte me zotër të gjallë dhe konkretë. Edhe zotërat e rinj gjithashtu kanë një fuqi proporcionale për të menaxhuar jetën e njerëzve të tjerë, por përbërja e tyre ndryshon në varësi të frikës së nënvetëdijes së qytetarit ose kolektivit. Teoritë e



konspiracionit janë përshtatur për të kënaqur mentalitetin dhe ndjenjat, duke u bërë një pasqyrë për përballjen në grup me mjedisin aktual. Kështu, teoritë e konspiracionit karakterizohen nga një përshtatshmëri e pabesueshme dhe tërheqje e parëzistueshme, pasi ato i tregojnë fajtorët sipas nevojave individuale dhe trazirave shoqërore.

Në kushte të pandemisë, teoritë e konspiracionit marrin gjithashtu përmasa pandemike.

Së pari, grupi i vogël dhe i zgjedhur i konspiratorëve zgjerohet, përmirësohet dhe diferençohet në mënyrë të paqartë në grupe të ndryshme njerëzish të fuqishëm. Në lojë janë industria farmaceutike, punëtorët mjekësorë dhe shkencorë; korporata të mëdha, por edhe përfaqësues individualë; qeveri dhe shtete të tëra, por edhe burra shteti. Pra, në një krizë komplekse me shumë çështje të pazgjidhura, ka kërkim masiv për përgjigje dhe përhapje masive të dezinformatave, kështu që çdokush mund të bëhet konspiracionist. Më tej, rritet numri dhe ndryshon përbërja e grupit të mbështetësve. Kështu, skeptikët dhe mohuesit e hapur të pandemisë, bashkohen me kundërshtuesit e vaksinimit (anti-vaxers) dhe mbajtjes së maskave (anti-maskers), ose mbështetësit e lëvizjeve të tjera (të tillë si aktivistët e QAnon dhe New Age). Në fund, rritet numri i narrativëve, të cilat mund të përpunohen në detaje ose jashtëzakonisht të çuditshme, kombinim i fakteve dhe fikSIONIT ose trillime të pastra.

Më poshtë është dhënë një përmbledhje e miteve më të zakonshme në lidhje me Kovid-19, të cilat janë të organizuara në tre grupe të përgjithshme, sipas temës që trajtojnë (fig. 8..

Grupi i parë përbëhet nga teori konspirative që prekin tema të **individualitetit** dhe pasqyrojnë shqetësimin e përgjithshëm për mundësinë e pretenduar të ndërhyrjes në të drejtat civile, liritë, besimet dhe zakonet. Për shembull, menjëherë pas shpalljes së pandemisë dhe vendosjes së masave rigoroze për mbrojtjen masive (të tilla si karantinat, orët policore dhe mbyllja e plotë e kufijve shtetërorë), u shfaqën teori konspirative në lidhje me planet e fshehta nga qeveritë për të vendosur autokraci, diktaturë totalitare ose shtet policor. Me shpikjen e vaksinave janë përhapur thashethemet në lidhje me ndjekjen e sjelljes (përmes kartonëve për evidencën e vaksinimit) ose ndjekjen e lëvizjes së popullsisë (përmes çipave të pretenduar që injektohen me vaksinën). Të dy narrativat u paraqitën nga frika e rrezikut të pretenduar nga kufizimi ose privimi i lirive qytetare të lëvizjes.

Grupi i dytë i madh i teorive të konspiracionit u referohet **aktorëve të rëndësishëm shoqërorë**, ndërsa vetë ato janë projeksion i frikës nga nënshtrimi politik ose ekonomik. Dominimi dhe fitimet financiare të supozuara u atribuohen sipërmarrësve (si George Soros ose Bill Gates), korporatave të tëra (kryesisht industrisë farmaceutike), e madje edhe shteteve të tëra kur perceptohen si konkurrentë të ndërsjellë (si në rastin e Kinës dhe Shteteve të Bashkuara).

Në fund, grupi i tretë i përmbajtjeve konspirative e kanalizon frikën fillestare të njeriut, d.m.th. frikën për **shëndetin, jetën dhe mbijetesën** e tij. Ato qarkullojnë nëpër hapësirën mediatike si një larmi narrativash, duke filluar me shprehjet e skepticizmit në lidhje me sigurinë e vaksinave (lidhur me procesin e prodhimit dhe përdorimit), përmes teorive të qarta të konspiracionit në lidhje me efektet negative të vaksinave (të tilla si steriliteti ose rritja e vdekshmërisë së popullsisë).



PËRMBAJTJE KONSPIRATIVE GJATË PANDEMISË



**TË DREJTA
DHE LIRI**



**MORAL, FE
DHE NORMA**

INDIVIDUALIZËM



**KAPITALIZËM
DHE EKONOMI**



**PUSHTET
DHE POLITIK**

SHOQËRI



**ZHVILLIM
DHE PRODHIM**



**SIGURI DHE
MBROJTJE**

SHËNDET

Foto. 8: Përmbajtje konspirative në kohën e pandemisë, në lidhje me frikën e rrezikimit të individualitetit, nënshtrimin politik ose ekonomik ndaj aktorëve socialë dhe frikën nga sëmundjet dhe dëmtimi i shëndetit

Pavarësisht nga arsyet e ndodhjes së tyre, pasojat e ekzistencës së tyre shoqërohen gjithmonë me mbështetjen e zvogëluar të ekspertëve dhe burimeve tradicionale të informacionit, si dhe menaxhimin e pafavorshëm të pandemisë. Për shembull, ithtarët e teorisë se stacionet bazë në rrjetin e ri të komunikimit celular 5G përmes rrezatimit ndihmojnë në zgjerimin e pandemisë së Kovid-19, kanë treguar gatishmëri më të madhe për të përdorur dhunë kundër transmetuesve dhe inxhinierëve. Në të vërtetë, ka pasur rreth 50 raste vandalizmi të transmetuesve në Mbretërinë e Bashkuar me lëndime të personelit. Në raste të tjera, rritet mbështetja për trajtime të paverifikuara dhe të rrezikshme (me hidrosiklorokinë ose argjend koloidal), si dhe praktikat e dëmshme parandaluese (p.sh. vetë-izolimi i tepërt ose akumulimi i ushqimit). Sidoqoftë, dyshimi i hapur, hezitimi dhe qëndrimi negativ ndaj vaksinimit duket se janë një nga problemet më të mëdha në popullsinë botërore sot. As populli ynë nuk është kursyer nga kjo dukuri. Kështu, rezultatet e një hulumtimi rajonat (të Grupit Këshillues për Politika “Balkans in Europe”) dhe një hulumtim vendor (i Institutit për Demokraci “Societas Civilis”), i kryer në mostra përfaqësuese me më shumë se një mijë të anketuar, treguan se përqindja e njerëzve që sigurisht nuk do të vaksinohen është 34, gjegjësisht 40 përqind e të anketuarve (për secilën nga sondazhet veç e veç), ndërsa përqindja e atyre që me gjasë nuk do ta bënin këtë është rreth 10, gjegjësisht 16 përqind (përkatesisht për secilën nga sondazhet). Nga ana tjetër, një hulumtim rajonat (nga Instituti i Politikave GLOBSEC) tregoi se 35% e qytetarëve në Maqedoni besojnë në teoritë e konspiracionit në lidhje me Kovid-19, ndërsa përqindja është rritur në 60% të të anketuarve që besojnë në dy nga katër teoritë të ngjashme, sipas rezultateve të një hulumtimi vendor (të Fondacionit për Internet dhe Shoqëri “Metamorfozis” dhe Qendrës për Strategji Evropiane “Eurothink”).

Është për të ardhur keq fakti që rreth gjysma e popullsisë sonë është e ndjeshme ndaj dezinformatave dhe nuk do të pajtohej me rekomandimet shëndetësore. Nga ana tjetër, nevojitet që mbi 70 përqind e popullsisë të imunizohet për të arritur imunitetin kolektiv. Kjo është arsyeja **pse vendosmëria e të tjerëve** për të **forcuar mendimin kritik** në mjedisin e tyre (tek prindërit, fëmijët, të afërmit dhe miqtë e tyre) duhet të jetë më e fortë. Lufta për të rritur vetëdijen publike nuk fillon nga institucionet, por nga vetja jonë. Ajo kërkon veprim të vazhdueshëm, me një qasje të informuar, të durueshme dhe të adaptuar ndaj secilit prej bashkëqytetarëve tanë.




VAKSINIMI INFORMATIV

Informacioni është si virus. Kur transmeton të pavërteta të mbuluara me senzacionalizëm, ai përhapet me shpejtësi dhe e shkatërron “indin e shëndoshë” të sistemit. Kur transmeton fakte pa konspiracione, ai hyn në simbiozë me “nikoqirët” dhe e “forcon funksionalitetin” e shoqërisë.

“Rezistenca e njeriut ndaj përmbajtjeve të dëmshme varet nga ekspozimi dhe sasia e atyre përmbajtjeve.”

Kjo deklaratë funksionon si në nivelin mjekësor ashtu edhe në atë të komunikimit. Është njësoj i zbatueshëm si për materialet informuese të paketuara në gjenet e koronavirusit të ri, ashtu edhe për dezinformatat në lidhje me të dhe të shpërndara në hapësirën mediatike. Kështu, një “dozë” më e lartë e “virusit” infektues dhe informativ do të thotë edhe ndjeshmëri më e madhe ndaj tij (në kuptimin e drejtpërdrejtë dhe figurativ të fjalës). Nga ana tjetër, rezistenca e zvogëluar ndaj përmbajtjeve të dëmshme përbën rrezik në rritje për shëndetin fizik dhe mendor të njerëzve.



Paralelja e mësipërme tregon se së bashku me depërtimin e virusit, po futen edhe nocione mjekësore dhe po bëhet medikalizimi i përshpejtuar i hapësirës publike. Një shembull klasik dhe i qartë i kësaj është termi “infodemi” (anglisht: infodemic). Ky term filloi të përdorej si shenjë për “pandeminë” nga “(dez)informimi” për të treguar përhapjen e tyre të shpejtë duke “infektuar” “persona”, të cilët do të shërbenin si burime të ardhshme të (dez)informatave. Termi “sëmundje informative” ose “çrregullim informativ” (anglisht: infomation disorder), nga ana tjetër, është pasojë logjike e infodemisë dhe do të thotë raportim kaotik dhe i paorganizuar, pra i parregulluar dhe i paekuilibruar, që përfshin plasimin e të pavërtetave të plota, kombinimin e trillimeve dhe fakteve, por gjithashtu edhe narrativeve shumë më komplekse, siç janë teoritë e konspiracionit. Çrregullimi mund të “përparojë” me shpejtësi të lartë dhe lehtësisht “të rrezikojë” funksionalitetin e sistemit. Nga ana tjetër, “kura” për këtë “çrregullim” ka një “prodhim” të ngadaltë, por një “efekt” të zgjatur. Ajo shoqërohet me procese afatgjata dhe të mundimshme, të tilla si gjetja e fakteve (hulumtimi shkencor), ose verifikimi i fakteve (gazetaria hulumtuese). Me fjalë të tjera, një “dietë e shëndetshme mediatike” kërkon përgatitje të gjatë, shumë përpjekje dhe përkushtim. Prandaj, zgjidhja e mundshme ndoshta nuk është insistimi për të gjetur një kurë, por ta shmangësh atë, gjegjësisht të mos vihet në fazën e “shërimit”. Pra, problemi me dezinformatat “është më mirë të parandalohet sesa ta shërohet”.

Vija e propozuar e të menduarit i ndjek disa nga rekomandimet e psikologëve socialë për “inokulimin psikologjik”. Kjo procedurë do t’i forconte natyrshëm mekanizmat psikologjikë për ndjeshmërinë e zvogëluar ndaj lajmeve të rreme dhe teorive të konspiracionit, dhe njëkohësisht do ta vendoste sistemin mbrojtës të njeriut në gatishmëri. **Ideja e inokulimit psikologjik është përsëri e huazuar nga mjekësia dhe është një analogji me procesin e vaksinimit.** Kështu, në inokulimin mjekësor, një virus “dobësohet” deri në pikën që nuk shkakton sëmundje, por megjithatë e zgjon përgjigjen imune të pacientit. Në mënyrë të ngjashme, me inokulimin psikologjik, potenciali i dëmshëm i një mesazhi të gabuar zvogëlohet deri në pikën ku ai nuk ka fuqi të shkaktojë ndryshime në qëndrimin kritik të marrësit ose arsyetimin racional të pranuesit, por megjithatë ta zgjojë aftësinë e tij analitike dhe ta zvogëlojë pranueshmërinë e tij për përmbajtje të ngjashme. Kjo strategji përfshin dy qasje që praktikohen para plasimit të informacionit: **paralajmërimi** (ang: forwarning) dhe **demaskimi parandalues** (ang: preemptive debunking ose prebunking). Paralajmërimi shërben për të treguar manipulimin e mundshëm me informacionin, ndërsa demaskimi parandalues ofron fakte dhe argumente që do të shërbenin për të hedhur poshtë dezinformatat e mundshme. Veprimet e “paralajmërimit” dhe të “demaskimit” e zgjojnë ndjenjën e “kërcënimit” dhe e vendosin marrësin e mesazhit në gjendje “gatishmërie”. Në këtë mënyrë, ai bëhet i gatshëm të aktivizojë mekanizmat njohës dhe afektivë në rast nevojë për të dhënë përgjigje të përshtatshme. Për shembull, ai do të ishte në gjendje të dallojë mospërputhjet logjike dhe paragjykimet njohëse në kohën e duhur, si dhe t’i demaskojë qëllimet manipuluese në rast të ekspozimit ndaj përmbajtjeve konspirative për Kovid-19 (siç tregohet në fig. 9).

Këto strategji në një farë mase u mbështetën edhe nga disa nga rrjetet kryesore sociale (të tilla si “Facebook” dhe “Instagram”), të cilat njoftuan se do të fillonin t’i shënonin në mënyrë të përshtatshme informatat që nuk janë të vërteta, por gjithashtu t’i drejtonin përdoruesit tek burimet zyrtare që lidhen me Kovid-19, të cilat janë të verifikuara dhe të besueshme.



PAPAGJYKIME TË NJOHURA PËP KOVID-19




Figura 9 Paragjykimet njohëse për Kovid-19

¹ Të dhënat janë marrë nga <https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/vaccines/safety/adverse-events.html>

² Marrë nga: <https://www.vox.com/science-and-health/2020/3/18/21184992/coronavirus-covid-19-flu-comparison-chart>


Për më tepër, këto strategji janë zbatuar edhe në lojërat provë në internet, të cilat inkurajojnë mendimin kritik dhe kujdesin e lojtarëve, për shembull duke i detyruar ata të imagjinojnë se si është të jesh një përhapës i lajmeve të rreme. Përmes taktikave të mundshme për të tërhequr mbështetës, lojtarët mësojnë t'i njohin skemat dhe përmbajtjet manipuluese. Hulumtimet e deritanishme kanë treguar se ndikimi i këtyre lojërave dhe kuizeve është i gjerë dhe kanë efekte premtuese në luftimin e dezinformatave në hapësirën publike, pavarësisht nga konteksti politik dhe kulturor. Prandaj, popullarizimi i përmbajtjeve të këtilla mund të shërbejë si ndërhyrje e vërtetë për imunizimin psikologjik të popullatës. Dhe në përgjithësi, të gjitha strategjitë që do t'i "luftonin dezinformatat" para se të marrin hov dhe do t'i "demaskonin" ato në mënyrë argëtuese janë të dobishme. Ato duken praktike (sepse mësojnë përmes demonstrimeve dhe ushtrimeve), ekonomike (sepse nuk kërkojnë investime të mëdha dhe parandalojnë shpenzime shtesë), angazhuese (për të gjithë profilet dhe të rriturit), por mbi të gjitha shpresdhënëse dhe premtuese.

LIDHJA E VËRTETË ME TEORITË E KONSPIRACIONIT

Lidhja që ekziston në mes besimtarit dhe teorive të tij të konspiracionit duket e fortë dhe e pathyeshme. Megjithatë, si çdo marrëdhënie, ajo nuk është immune ndaj ndërhyrjeve të palëve të treta. Nga ana tjetër, ndërmjetësimi i suksesshëm përfshin vullnetin e mirë dhe një dozë të caktuar të shqetësimit personal, si dhe sasi të pakufizuara të ndjeshmërisë, taktit dhe diplomacisë. Këto janë aftësi komunikimi, që në kohë të pandemisë vlejnë për të gjitha profilet dhe profesionet që vijnë në kontakt me besimtarët në teoricienët e konspiracionit (të afërm dhe miq, mjekë dhe gazetarë).

“Lidhja që bazohet në konspiracion dhe dyshim paraprakisht është e destinuar të dështojë”

Kjo deklaratë i pasqyron në mënyrë të barabartë edhe zhvillimet reale midis **abuzuesve** dhe **viktimave të tyre**, por edhe lidhjet simbolike midis besimtarëve dhe teorive të tyre të komplotit. Me ndryshimin që “besimtari” që krijon një mjedis komploti dhe intrigash, nuk mund të paraqitet si “abuzues”, por si “viktimë” e teorive të veta. Me të vërtetë, ai krijon marrëdhënie intime dhe të afërt me besimin e tij, i cili mund të mbijetojë edhe në rast të tentimeve më të forta të përpjekjeve qëllimmira për ta çbindur. “Besimtari” atëherë «vuan» nga simptomat klasike të «abuzimit». Kështu, ai ka ndjenjë të vazhdueshme të «kërcënimit»



të shoqëruar me mosbesim dhe tjetërsim nga të afërmit e tij, si dhe pasiguri në lidhje me pasqyrën e vërtetë të botës. Si duket teoritë e konspiracionit nuk janë aq të rrezikshme për "kundërshtarët" e imagjinuar ose shoqërinë, sa janë të rrezikshme për mbështetësit e tyre. Prandaj, strategjitë për trajtimin e teorive të konspiracionit (d.m.th. parandalimi, demaskimi ose kufizimi i tyre) duhet të drejtohen kryesisht tek ithtarët dhe shpërndarësit kryesorë (d.m.th. vetë besimtarët).

Teknikat për t'i parandaluar ato mund të jenë veçanërisht efektive, pasi ato i prekin karakteristikat kryesore të besimtarëve në teoritë e konspiracionit, përkatësisht ndjeshmërinë ndaj kërcënimit dhe prirjen për mosbesim. Më saktë, paralajmërimi i manipulimit të mundshëm (ang: forenwarning) dhe demaskimi i parakohshëm i dezinformatës (ang: prebunking), i kanalizon prirjet e besimtarit (drejt mosbesimit dhe ndjeshmërisë ndaj kërcënimeve) dhe i orienton ato drejt qëllimit të duhur: vetë teoritë e konspiracionit.

Nga ana tjetër, **teknikat e demaskimit** (ang. debunking) **të tyre kanë efekt të kufizuar**, kështu që kërkojnë përpjekje të vazhdueshme të secilit individ të përgjegjshëm. Praktika e zakonshme e demaskimit të teorive të konspiracionit përfshin tre hapa: 1) të fillohet me renditjen e fakteve që korrespondojnë me të vërtetën objektive; 2) të bëhet një analizë e teorive të konspiracionit, me theks të veçantë në gabimet logjike, paragjykimet dhe mospërputhjet që ato i përmbajnë; 3) të përfundohet duke i theksuar faktet, argumentet dhe të vërtetën objektive.

Ky i ashtuquajtur "sanduiç i së vërtetës" përmban tre shtresa informacioni me një renditje të qartë dhe precize: "gënjeshtër" gjithmonë shtypet nga të dy palët me "të vërtetën", e po ashtu edhe nga dy shtresat e fakteve. "Receta" për një "sanduiç" të tillë u rekomandohet gazetarëve, për të siguruar një "dietë të shëndetshme mediatike" për gjithë popullsinë. Për gazetarët është e këshillueshme që të ndjekin rendin e deklaruar në raportim, pasi zakonisht atyre u kërkohet të mbulojnë të gjitha anët e një tregimi. Pra, është mirë të fillohet me fakte (sepse fillimi është mbresëlënës, kështu që mbetet në kujtesë), por është mirë edhe të mbarohet me to (për t'i shtypur gënjeshttrat dhe të mbetet e vërteta).

Në kohë krizash shëndetësore, është e zakonshme që qytetarët të kërkojnë këshilla nga mjekët e tyre, kështu që vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet strategjive të komunikimit nga **profesionistët mjekësorë**, pasi ata bëhen zëdhënës të së vërtetës dhe demaskues të teorive të konspiracionit në lidhje me Covid-19. Në këtë kuptim, marrëdhënia tradicionale mjek-pacient, e cila bazohet në rekomandime të gatshme nga autoritetet, duhet të zëvendësohet me qasje që bazohet në dëgjim dhe bisedë aktive. Kjo do të thotë të bëni pyetje të hapura (në vend të ofrimit të përgjigjeve të gatshme) dhe t'i respektoni shqetësimet dhe mendimet e njerëzve të tjerë (në vend që t'i nënvlerësoni ato). Në këtë mënyrë, do të identifikohen dhe adresohen si duhet burimet e keqkuptimeve, përmes një atmosfere miqësore bashkëpunimi midis mjekut dhe pacientit.

Në fund, në epokën e rrjeteve sociale, **qytetarët** bëhen media dhe burime të (dez)informimit për rrethin e tyre të miqve dhe të ndjekësve. Kështu që secili prej nesh individualisht mund të ndihmojë në luftimin e teorive të konspiracionit, nëse i përmbahemi disa rekomandimeve të thjeshta (fig. 10). Në fillim, është e rëndësishme të vlerësohet nëse qëndrimi apo narrativi i shprehur është teori konspirative dhe nëse është



REKOMANDIME PËR KOMUNIKIM GJATË ZBULIMIT TË DEZINFORMATAVE

ZGJIDH BASHKËBISEDUESIT



Vlerësoni nivelin e gatishmërisë dhe hezitimit



Parashtroni pyetje të hapura

BISEDONI VETËM



Pranoni qëndrime të ndryshme emocionale



Identifikoni pikëpamjet dhe opinionete përbashkëta

JINI TË DURUESHEM



Pajtohuni për faktet dhe çështjet e pazgjidhura



Pyesni për burime të tjera informacionesh

VENDOSNI BESIM



Informoni, mos bindni. Mos mbingarkoni me të dhëna



Mbështetuni në burimet e shëndosha të informacioneve

NË MËNYRË AKTIVE ZBULO DEZINFORMATATA DHE TEORI KONSPIRATIV



Përshtateni mesazhin me bashkëbiseduesin tuaj



Kur të kesh mundësi, ndihmo të kuptohen të dhënat statistikore



Nëse është e nevojshme, shpjegoni se si funksionon interneti



Praktiko inakulum psikologjik

Figura 10: Rekomandime për komunikim gjatë demaskimit të dezinformatave dhe gjatë bisedës me besimtarët në teoritë e konspiracionit



e rrezikshme për shëndetin e njeriut. Ato teori konspirative që nuk kanë pasoja të mëdha për shumë njerëz (për shembull, besimi se Toka është e rrafshët) ose nuk janë mjaft të përhapura në mesin e njerëzve, është më mirë të mos komentohen ose shpërndahen, në mënyrë që të mos përforcohen. Pastaj, duhet vlerësuar nëse bashkëbiseduesi potencial është i hapur për bisedë dhe a ka vend për shkëmbim mendimesh. Biseda me ithtarët e ngurtë të teorive të konspiracionit nuk premtan rezultat pozitiv dhe shpesh shkon në dëm të palës tjetër. Nëse ka vend për bisedë, këshillohet ta bëni atë vetëm, për të lejuar sinçeritetin pa presion nga mjedisi (p.sh. dëshira për të sulmuar ose për t'u mbrojtur para të tjerëve). Në fillim të bisedës, duhet të kërkohet filli që i lidh pikëpamjet e përbashkëta të dy bashkëbiseduesve dhe të fillohet nga një pozicion i përbashkët. Teoritë e konspiracionit janë bindëse sepse përmbajnë edhe disa dyshime të bazuara ose i ngatërrojnë trillimet me fakte, kështu që fragmentet e së vërtetës duhet të shërbejnë si pikë fillestare për diskutim. Gjatë bisedës, duhet theksuar paanshmëria dhe objektiviteti personal (mungesa e interesave të treta). Në rrethana ideale, biseda do të zhvillohej gradualisht (duke e shqyrtuar secilën tezë veç e veç) dhe pa u përpjekur ta bindësh palën tjetër, por me qëllim të mirëkuptimit të ndërsjellë. Faktet do të prezantohen pa moralizim (ndaj bashkëbiseduesit) dhe pa ngarkesë (të diskutimit). Dhe lidhja/zgjidhja e vërtetë me teoritë e konspiracionit, do të ishte shpërblimi përfundimtar nga këto biseda.



SHEMBUJ TË DEMASKIMIT TË TEORIVE TË KONSPIRACIONIT ME VERIFIKIM TË FAKTEVE

QËLLIMI I VAKSINAVE NUK ËSHTË TË VRASIN NJERËZIT

Teoria e konspiracionit pretendon se Covid-19 është mashtrim për gjenocid global të popullsisë, dhe u bën thirrje qytetarëve që t'i refuzojnë vaksinat. Në të thuhet se vakcina jepet në tre doza, të cilat synojnë t'i vrasin njerëzit në tre faza. Ky pretendim është i pasaktë nga ana mjekësore dhe i rrezikshëm për shëndetin kolektiv të njerëzve:

„Vaksina e parë – i përjashton qelizat e bardha të gjakut (sistemin imunitar) dhe me këtë përjashtohet plotësisht sistemi imunitar i njeriut dhe kjo krijon deficit imunitar. Vaksina e dytë e ngarkon trupin me toksina vdekjeprurëse, pra, vakcina e dytë fut metale të ndryshme të lehta dhe të rënda në trupin e njeriut. Në këtë fazë toksinat shpërndahen në organizëm, pra në trup, por personi nuk ndihet i sëmurë, sepse sistemi imunitar nuk e lufton atë. Vaksina e tretë – e riaktivizon sistemin imunitar, i cili e detyron sistemin imunitar të krijojë një rrjedhë shpërthyesë të sëmundjes. Lirimi i sistemit imunitar provokon sulm të fuqishëm të toksinave që e vrasin njeriun. Ky efekt njihet si stuhi citokine, kur sistemi imunitar tronditet aq shumë saqë dërgon shumë antitrupa në pjesët e infektuara. Kështu trupi e vret veten

CILAT JANË FAKTET?

Kjo teori konspirative i është atribuar një memorandum të pretenduar të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) të vitit 1972. Por, sigurisht, ky pretendim dhe plani i pretenduar për të shkatërruar popullsinë e botës nuk është bërë nga OBSH-ja dhe nuk ishte pjesë e ndonjë memorandum.

Bëhet fjalë për një fragment (citim) nga libri i shkruar nga autorja ruse, Tatjana Graçova "Kur pushteti nuk është nga Zoti", i botuar në vitin 2010. Teksti i cituar më lart është në faqen 64 të këtij libri në gjuhën serbe, në kapitullin me titull "Vaksinat janë armë për shkatërrim masiv".

Ky postim i referohet pandemisë së gripit të dërrit të vitit 2009 të shkaktuar nga virusi i gripit A, nëntipi H1N1 (A/H1N1). Libri thotë se një studiues, Patrick Jordan, zbuloi disa memorandume të OBSH-së. Verifikimi ynë i fakteve zbuloi se memorandum i OBSH-



së i cituar në libër titullohej "Imunopatologjia e lidhur me viruset: Modelet e kafshëve dhe implikimet për sëmundjet e njerëzve".

Publikimi i plotë u botua në ueb-faqen e arkivit më të madh të shkencave natyrore dhe biomjekësore, "PubMed Central", më 6 shkurt 1973, kështu që ishte në dispozicion 36 vjet para pandemisë së gripit të derrit të vitit 2009, pra është e qartë se Patrick Jordani nuk ka pasur çfarë të zbulojë, sepse ky memorandum është në dispozicion të publikut për dekada me radhë. Megjithëse nuk ka shumë informacion në internet për Patrick Jordanin, është e qartë se ai ka faqen e tij mbi narrativat anti-vaksinë dhe teoritë e konspiracionit.

Në memorandumin e OBSH-së thuhet se viruset, përveç që janë të rrezikshëm vetvetiu dhe mund të shkaktojnë dëmtime të indeve, gjithashtu mund të shkaktojnë reagimin e tepërt imunologjik të trupit, duke çuar në shkatërrimin e qelizave të shëndetshme në sistemin imunitar. E ashtuquajtura "stuhi citokine" është shembull i një reagimi të tillë. Siç thuhet në përfundim, ky memorandum ka dy pjesë dhe i paraqet arritjet e atëhershme në fushën e imunopatologjisë virale, gjegjësisht konstaton se konceptet e reja janë të rëndësishme për sëmundje të caktuara te njerëzit

Memorandumi nuk i përmend fare vaksinat, aq më pak vrasjet përmes vaksinimit me tre doza!

JASHTË REALITETIT


Imunologjia **Emina Millosheviq** thotë se **memorandumi i OBSH-së nuk lidhet fare me vaksinat**. Ajo thekson se vaksinat nuk mund ta "ndezin" (ta aktivizojnë) ose "ta fikin" (ta çaktivizojnë) imunitetin.

"Është kaq e mjegullt dhe e pabazuar sa nga të gjitha teoritë e konspiracionit që kam dëgjuar deri më tani, kjo është disi më e largët nga realiteti. Mua, si imunologe, nuk më bie në mend asgjë që mund ta bëjë diçka të tillë, asnjë substancë nuk mund ta bëjë atë, thotë ajo."

Shefi i Departamentit të Imunologjisë Klinike dhe Sëmundjeve Infektive në Spitalin Universitar "Henry Mondor" dhe në Institutin e Hulumtimit të Vaksinave, Jean Daniel Lelivre, për AFP thotë:

"Ky dokument nuk ka asnjë lidhje me vaksinat. Po të ishte kështu, njerëzimi do të ishte shkatërruar tashmë, sepse të gjithë kanë marrë 3 doza të së njëjtës vaksinë" duke iu referuar procedurave standarde të vaksinimit kundër disa sëmundjeve.

Në faqen e vaksinimit të Ministrisë së Shëndetësisë të Maqedonisë së Veriut, thuhet se vaksina nuk mund t'u infektojë me COVID-19.



„Vaksina nuk përmban asnjë pjesë të gjallë ose aktive të virusit Kovid-19. Nuk do të shkaktojë test pozitiv, me të cilin testohet infeksioni aktiv me KOVID-19. Disa njerëz që kanë marrë vaksinën kanë raportuar efekte anësore të lehta ose mesatare, duke përfshirë dhimbjen në vendin e injeksionit, lodhje, dhimbje të kokës dhe dhimbje të muskujve. Jo çdokush ka efekte anësore. Por nëse ka, ato janë normale dhe shenjë se trupi juaj e ndërton mbrojtjen e tij kundër virusit”- thuhet në faqe.

Vaksinat funksionojnë në mënyrë që krijojnë imunitet kundër sëmundjes, jo në mënyrë që të shkatërrojnë imunitetin ekzistues.

Prandaj, konkludojmë se pretendimi se vaksina në tre doza vret, si dhe pretendimi se e gjithë kjo ishte deklaruar në një memorandum të OBSH-së nga viti 1972, është i pavërtetë..

(marrë dhe përshtatur nga crithink.mk)

NUK NDALONJË TEORITË E KONSPIRACIONIT SE PO NA SPËRKATIN ME HELME NGA AJRI!

Teoria konspirative e përhapur shumë, e cila fut panik se dofarë grimca helmuese biologjike ose kimike po hidhen nga qielli, dhe prova kryesore e kësaj janë gjurmët që i lënë pas aeroplanët! Teoria e njohur e konspiracionit, e cila në fenomenim më të zakonshëm fizik të kondensimit sheh komplot kundër njerëzimit, përmes programi të fshehtë të spërkatjes së helmit.

Sipas këtij narrativi, qytetarët "spërkaten" me helme nga ajri. Kjo, praktikisht, është një tjetër nga seria e rrëfimeve konspirative, që shkojnë në vijën e dyshimit se nga aeroplanët lëshohen toksina të rrezikshme, të cilat synojnë të shkaktojnë dëme masive në shëndetin e qytetarëve.

Ky postim, ndër të tjera, pretendon:

"Sot nuk e kursyen fare helmin. Me intensitetin më të lartë.

Çfarë po presim? A ka mbetur dikush normal? A ka ndonjë gjë më të shenjtë për të cilën ia vlen të jetohet - pikërisht jetët tona? A ka thirrje më të madhe për të luftuar sesa për shëndetin e fëmijëve tanë?"



Megjithëse nuk është specifikuar se çfarë nënkuptohet më konkretisht, konteksti është i qartë, dhe, në fakt, kjo konfirmohet nga komentet poshtë postimit - se, gjoja, është një helmim i popullatës nga ajri.

Teori të tilla konspirative "kemtreils", të cilat në fenomenin më të zakonshëm fizik të kondensimit shohin komplot kundër njerëzimit përmes një programi sekret për të spërkatur kimikate helmuese, janë demaskuar në mënyrë të përsëritur nga verifikuesit e fakteve, duke përfshirë shërbimin çek për verifikimin e fakteve (Manipulátoři.cz), shërbimi serb (Istinomer.rs), si dhe në disa recensione të "Vërtetmatësit".

Sipas studiuesve në Universitetin e Harvardit në Shtetet e Bashkuara, të cilët i kanë studiuar teoritë e tilla të konspiracionit, "nuk ka asnjë provë të besueshme se ekzistojnë 'kemtrails'".

Gjithashtu, në lidhje me këtë temë "Forbes" publikoi një studim në të cilin një panel prej 76 kimistësh dhe shkencëtarësh nga Universiteti "Irvin" në Kaliforni, deklaruan se ata kurrë nuk kishin gjetur prova që kishte programe të spërkatjes kimike në shkallë të gjerë nga avionët në mënyrë që të dëmtonin shëndetin e qytetarëve dhe për të ndikuar në atmosferë.

"Kjo teori konspirative daton që nga shfaqja e internetit. Ende mund të gjeni faqe të shumta në internet që promovojnë këtë lloj pseudoshkence. Sondazhi ynë tregon se pohimet se qeveria, ushtria, kompanitë ajrore dhe entitetet e tjera janë bashkuar në një mision të gjerë për ta helmuar planetin përmes spërkatjeve ajrore kanë arritur pak konsensus nga komuniteti shkencor", thotë Stephen Davis, profesor dhe shkencëtar në Universitetin "Irvin" në Kaliforni..

Sipas hulumtimit, arsyeja pse gjurmët e avionëve mbeten të dukshme është për shkak të lartësive më të larta të fluturimit, gjë që rezulton në gjurmët e kondensimit që zgjasin më shumë. Fakti që gjurmët e avionëve kryqëzohen është provë se ka frekuencë të shtuar të trafikut ajror, gjegjësisht se ka shumë më shumë aeroplanë që marrin pjesë në trafikun ajror, që është arsyeja kryesore pse disa prej tyre duhet të fluturojnë më lartë.

Në fund, të përmendim se për këtë "helm", që gjoja "lëshohet në intensitet më të fortë", nuk kemi dëgjuar të ketë shkaktuar helmim masiv? Në të njëjtën kohë, nuk duhet të neglizhohet as "thirrja për luftë për shëndetin e fëmijëve tanë", duke pasur parasysh se ky njoftim mashtrues është mjaft "viral", gjegjësisht me një numër të madh ndjekësish, shpërndarësish dhe mbështetësish, si dhe shumë ndërveprime, të cilat kryesisht e përforcojnë këtë teori konspirative. Dhe kjo, gjithsesi, është shkatërruese.

(marrë dhe përshtatur nga crithink.mk)



ÇFARË (NUK) ËSHTË E PËRBASHKËT NË MES 5G DHE KORONAVIRUSIT?


Lidhja konkrete midis Kovid-19 dhe rrjetit 5G u krijua kur filluan të qarkullojnë teoritë se nuk ishte rastësi që sëmundja e re dhe rrjeti 5G kishte të njëjtin vend të origjinës (Kinën). Disa teori sugjerojnë që rrezatimi nga rrjeti 5G dobëson përgjigjen imune tek njerëzit, ndërsa të tjerët sugjerojnë që e përshpejton infeksionin me koronavirusin. Sipas teorisë së treta, sëmundja Kovid-19 u shpik për t'i mbuluar pasojat shëndetësore të teknologjisë 5G. Sipas kësaj teorie, simptomat e virusit: ethe, kollë dhe frymëmarrje e vështirësuar, në fakt janë reagimi i trupit të njeriut ndaj ekspozimit ndaj valëve 5G. Teoritë e tilla pranohen me skepticizëm nga ekspertët, të cilët tregojnë se rastet e koronavirusit janë identifikuar në shumë vende ku ende nuk ka rrjet 5G. Çfarë thonë ekspertët?

"Ideja që 5G dobëson sistemin tuaj të mbrojtjes është e paqëndrueshme. Sistemi juaj imunitar mund të dobësohet nga shumë gjëra: nga një ditë e lodhshme e deri në një dietë të dobët. Këto variacione, megjithëse të parëndësishme, megjithatë e rrisin rrezikun e infektimit me virusin. Nga ana tjetër, radio-valët e forta mund të shkaktojnë ngrohje, por diapazoni i energjisë së valëve 5G është mjaft i vogël dhe konsiderohet e pamundur të ndikojë në sistemin imunitar. Ka pasur shumë studime për këtë," tha për BBC, Simon Clark, doktor i biologjisë molekulare.

Duhet të futet ilustrimi i mëposhtëm:

https://ichef.bbci.co.uk/news/976/cpsprodpb/2682/production/_107885890_5ggraphic-nc.png


KU BËN PJESË 5G NË SPEKTRIN ELEKTROMAGNETIK?




MPërhapja masive e dezinformatave për lidhjen midis instalimit të rrjetit 5G dhe koronavirusit ka arritur përmasa alarmante. Ato gjithashtu nxitën edhe aktivitete konkrete me vandalizëm. Si rezultat i këtyre teorisë të konspiracionit, në Mbretërinë e Bashkuar (në Belfast, Liverpool dhe Birmingham), por edhe në vende të tjera si në Suedi, Belgjikë, Itali dhe Kroaci, u raportuan dhjetra raste të dhunës, përkatësisht të



djegies së antenave të kompanive celulare në shenjë proteste kundër teknologjisë 5G. Në vazhdim janë dhënë linket deri te disa nga publikimet origjinale të incidenteve:



- [Birmingham 5G mast goes up in flames in 'likely' arson attack](#)



- [Telecom masts set alight as social media fuels the flames of 5G virus conspiracy](#)



Në një deklaratë të përbashkët, kompanitë e telefonisë celulare në Mbretërinë e Bashkuar, BT Group, Telefonica, O2, Vodafone dhe Tri, në pronësi të "CK Hatchison Holdings" (CK-HUY), thanë se pretendimet për 5G në asnjë rast nuk kishin lidhje me pandeminë.

"Jo vetëm që këto pretendime janë të pabazuara, ato janë të dëmshme për njerëzit dhe bizneset që mbështeten në vazhdimësinë e shërbimeve tona. Ato gjithashtu abuzuan me inxhinierët tanë dhe në disa raste, parandaluan mirëmbajtjen themelore të rrjetit", thanë operatorët celularë.

RRJETET SOCIALE DHE TEORIA E KONSPIRACIONIT PËR LIDHJE TË TEKNOGJISË 5G ME KORONAVIRUSIN

Rrjeti social "Facebook" kontrollon në mënyrë aktive grupet në të cilat përhapet ky informacion, dhe përkundër zbatimit të politikave të tij për të luftuar lajmet e rreme, ka vepruar në përputhje me politikën e veta kundër dhunës.

„Facebook bllokoi dy grupe anti-5G gjatë fundjavës pasi anëtarët inkurajuan shkatërrimin e stacioneve bazë të telefonive celulare, që është në kundërshtim me politikën e kompanisë për të promovuar dhunën. Anëtarët e grupit gjithashtu promovuan dezinformata që lidhin teknologjinë 5G me shfaqjen e koronavirusit.

Grupi Stop 5G mbledhi rreth 60,000 anëtarë dhe fillimisht filloi si grup që merrej me rrjetin më të shpejtë të internetit. Një grup tjetër, "Shkatërroni 5G Ruani Fëmijët Tanë", kishte më shumë se 2,500 anëtarë, që gjithashtu u hoq", shkruan [Businessinsider.com](https://www.businessinsider.com).

Anëtarët e këtyre grupeve promovuan vandalizimin e antenave 5G dhe stacioneve bazë në Mbretërinë e Bashkuar. Midis tyre madje kishte diskutime të hapura për plane për sulme të tjera të ngjashme.

BBC raporton se YouTube po bllokoi të gjitha teoritë e konspiracionit që lidhën në mënyrë të gabuar simptomat nga koronavirusi me rrjetin 5G. Vendimi u mor pas një interviste të drejtpërdrejtë me David Ike, në të cilën ai lidh teknologjinë me pandeminë. YouTube njoftoi se videoja do të fshihet.

Gjatë intervistës, Ajk pretendoi në mënyrë të gabuar se kishte një lidhje midis 5G dhe kësaj krize shëndetësore.

I pyetur në lidhje me përgjigjen e tij ndaj zjarreve të antenës 5G në Angli dhe Irlandën e Veriut, ai tha: "Nëse 5G vazhdon të arrijë atje ku duan ta çojnë, jeta njerëzore do të marrë fund, kështu që njerëzit duhet të bëjnë diçka", shkruan [пишува „Би-Би-Си“](https://www.bbc.com).

Shumë përdorues, duke komentuar këtë intervistë, bënë thirrje për më shumë sulme ndaj stacioneve 5G. Nga teori të ngjashme konspirative lind lidhja midis teorisë së "mikroçipit" në organet e kontrollit njerëzor dhe teorive që lidhin Bill Gates (themeluesi i Microsoft) me të gjitha ato. Këto teori diskutohen gjithashtu në intervistën e përmendur.

Ajk gjithashtu pohoi se vaksina e koronavirusit, kur do të zbulohet, do të përfshinte "mikroçipa të nanoteknologjisë" që do të mundësonte kontrollim



të njerëzve. Ai shtoi se Bill Gates, i cili ndihmon në financimin e fondit kërkimor të vaksinave kundër Kovid-19, duhet të shkojë në burg.– shkruan BBC.

INFORMIMI TEK NE

Tek ne janë publikuar disa përmbajtje që tregojnë lidhje të mundshme midis gjendjes së jashtëzakonshme të vendosur për shkak të koronavirusit dhe instalimit të rrjetit 5G, së bashku me "fenomenet negative" ose "pasojat" që po përflitet t'i ketë ky rrjet. Pretendohet se antenat e rrjetit 5G janë instaluar në disa vende dhe se ato kanë ndikim në vdekjen e qenieve të gjalla. Artikuj të tjerë pohojnë se ora policore (e cila është masë e ndalimit të lëvizjes së qytetarëve në kohë të caktuara) përdoret për të lejuar operatorët të montojnë fshehurazi antena të rrjetit 5G.


Bashkangjitur janë disa shembuj të botuar në mediat tona:

The screenshot shows the homepage of the KURIR news website. At the top, there is a navigation bar with categories like 'МАКЕДОНИЈА', 'СВЕТ', 'РЕПУБЛИКА', 'СЦЕНА', 'МАГАЗИН', 'СПОРТ', 'КОЛУМНИ', 'ТВ ИТОВИ', and 'ENGLISH'. Below the navigation bar, there is a main headline: 'Врапчиња паѓаат на земјата, граѓаните не знаат што се случува - помор на врапчиња низ цела Македонија (ФОТО)'. The headline is accompanied by a photograph of a bird on the ground. To the right of the main headline, there are several smaller news snippets, including one about 'Горѓиевски: Моите приоритети се отворена општина, целосна дигитализација на услугите, сектор за ИПА фондови и ревизија на сите ДУП-ви во Кисела Вода' and another about 'Арсовски: Дали Заев и Спасовски се плашат да спроведат истрага кој пукал на митингот на ДУМ или ги штитат криминалците кои пукаат?'. At the bottom of the page, there is a section titled 'НАЈЧИТАНИ ВЕСТИ' (Most Read News) with a list of five items, including 'Кардиологија: Работиме со целосен капацитет, пациентите да продолжат со својата рутинска нега на срцето' and 'Хамилтон често размислува за пензија'.

- Harabelat bien në tokë, qytetarët nuk e dinë se çfarë po ndodh - shfarosje e harabelave në mbarë Maqedoninë (FOTO)



- Maqedoni / A1 ka nisur montimi i antenave 5G! Na morët n'qafë Ooo Qeveri!



Извор: [Вистиномер](#)

- Gjatë kohës së orës policore janë vendosur antena në afërsi të fshatit Bogovinë (Tetovë)!
- Zogjtë ngordhën nga rrjeti 5G, thonë qytetarët!

Akuzat mbi këtë bazë nuk kanë të bëjnë me aktivitetet rreth rrjetit 5G, sepse frekuencat për përdorimin e shërbimeve 5G nuk janë vendosur akoma nga Agjencia e Komunikimeve Elektronike (qershor 2021), thanë nga A1, në një përgjigje të publikuar nga “Crithink”.

Nuk ka prova që teoritë e përmendura janë të vërteta, se fenomenet e përmendura janë të lidhura me njëra-tjetrën, ose se ato janë shkak i krizës globale të pandemisë. Për sa



kohë që operatorët informojnë hapur dhe publikisht në lidhje me punën e tyre në lidhje me instalimin e rrjetit 5G, është e pasaktë të pretendohet se ajo është bërë në fshehtësi gjatë orës policore. Gjithashtu nuk ka asnjë indikacion ose studim që zogjtë ngordhën si rezultat i "valëve të dëmshme" 5G, të cilat, në fakt, nuk janë aplikuar ende në vendin tonë. Nuk ka asnjë provë që bota duhej të shpikte koronavirusin për të mbuluar "efektet e rrjetit 5G" në shëndetin e njeriut dhe gjallesat e tjera. Pra, sipas studimeve aktuale, **rrjeti 5G dhe koronavirusi nuk kanë asgjë të përbashkët.**


(marrë dhe përshtatur nga crithink.mk)




BURIMET

ADRESAT DHE TITUJT E TEKSTEVE TË PUBLIKUARA


1. Shëtitje e shkurtër në botën e teorive konspirative

 www.crithink.mk/kus-vodich-niz-svetot-na-zagovorite/


2. Skena e konspiracioneve si skenë krimi

 www.crithink.mk/sczenata-na-zagovor-kako-sczena-na-zlostor/


3. Konspiracionet në syrin e vëzhguesit

 www.crithink.mk/teorijata-na-zagovor-kako-nevidliv-zatvor/


4. Teoria e konspiracionit si burg i padukshëm

 www.crithink.mk/konspirativnosta-e-vo-okoto-na-nabluduvachot/


5. Teoritë e konspiracionit: Justifikim i mirë, kërkim për përgjigje ose përpjekje për bisedë?

 www.crithink.mk/teorii-na-zagovor-dobar-izgovor-potraga-po-odgovor-ili-obid-za-razgovor/


6. Teori të rrezikshme konspiracioni

 www.crithink.mk/опасni-teorii-na-zagovori/


7. Teori konspirative me përmasa pandemike

 www.crithink.mk/teorii-na-zagovori-od-pandemiski-razmeri/

8. Vaksinim informativ

 www.crithink.mk/informacziska-vakczinaczija/

9. Lidhja e vërtetë me teoritë e konspiracionit

 www.crithink.mk/vistinska-razvraska-so-teoriite-na-zagovori/



LITERATURA E REKOMANDUAR

- Bartlett, J., & Miller, C. (2010).** *The power of unreason: Conspiracy theories, extremism and counter-terrorism.* London: Demos. Достапен на: <http://westernvoice.net/Power%20of%20Unreason.pdf>
- Butter, M., Drążkiewicz, E., Dyrendal, A., Harambam, J., Jolley, D., Klein, O., Knight, P., Krekó, P., Lewandowsky, S., & Oberhauser, C. (2020).** Guide to conspiracy theories. *Education Group of the EU COST Action on Comparative Analysis of Conspiracy Theories (COMPACT).* Достапен на: https://conspiracytheories.eu/_wp-content/uploads/2020/03/COMPACT_Guide-2.pdf
- Lewandowsky, S., & Cook, J. (2020).** *The conspiracy theory handbook.* John Cook, Center for Climate Change Communication, George Mason University. Достапен на: https://conspiracytheories.eu/_wp-content/uploads/2020/03/ConspiracyTheoryHandbook.pdf
- Lewandowsky, S., Cook, J., Schmid, P., Holford, D. L., Finn, A., Leask, J., ... & Vraga, E. K. (2021).** *The COVID-19 Vaccine Communication Handbook: A practical guide for improving vaccine communication and fighting misinformation.* Достапен на: <https://hackmd.io/@scibehC19vax/home>
- Lewandowsky, S., Cook, J., Ecker, U. K., Lewandowsky, S., Cook, J., Ecker, U. K. H., & Newman, E. J. (2021).** The Debunking Handbook 2020. Достапен на: <https://sks.to/db2020>

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. PUBLIKIMET SHKENCORE

- Andrade, G. (2020).** Medical conspiracy theories: cognitive science and implications for ethics. *Medicine, Health Care and Philosophy*, 1-14. DOI: <https://doi.org/10.1007/s11019-020-09951-6>
- Blastland, M., Freeman, A. L., van der Linden, S., Marteau, T. M., & Spiegelhalter, D. (2020).** Five rules for evidence communication. *Nature*. DOI: <https://doi.org/10.1038/d41586-020-03189-1>
- Brady, W. J., Wills, J. A., Jost, J. T., Tucker, J. A., & Van Bavel, J. J. (2017).** Emotion shapes the diffusion of moralized content in social networks. *Proceedings of the National Academy of Sciences*, 114(28), 7313-7318. DOI: <https://doi.org/10.1073/pnas.1618923114>
- Bruder, M., Haffke, P., Neave, N., Nouripanah, N., & Imhoff, R. (2013).** Measuring individual differences in generic beliefs in conspiracy theories across cultures: Conspiracy Mentality Questionnaire. *Frontiers in psychology*, 4, 225. DOI: <https://doi.org/10.3389/fpsyg.2013.00225>
- Cichocka, A., Marchlewska, M., & De Zavala, A. G. (2016).** Does self-love or self-hate predict conspiracy beliefs? Narcissism, self-esteem, and the endorsement of conspiracy theories. *Social Psychological and Personality Science*, 7(2), 157-166. DOI: <https://doi.org/10.1177/1948550615616170>
- Douglas, K. M. (2021).** Are conspiracy theories harmless? *The Spanish journal of psychology*, 24. DOI: <https://doi.org/10.1017/SJP.2021.10>
- Douglas, K. M. (2021).** COVID-19 conspiracy theories. *Group Processes & Intergroup Relations*, 24(2), 270-275. DOI: <https://doi.org/10.1177/1368430220982068>
- Douglas, K. M., Sutton, R. M., & Cichocka, A. (2017).** The psychology of conspiracy theories. *Current directions in psychological science*, 26(6), 538-542. DOI: <https://doi.org/10.1177/0963721417718261>
- Duckitt, J., Wagner, C., Du Plessis, I., & Birum, I. (2002).** The psychological bases of ideology and prejudice: Testing a dual process model. *Journal of personality and social psychology*, 83(1), 75. DOI: <https://doi.org/10.1037/0022-3514.83.1.75>
- Gjoneska, B., Fidanovski, K., & Krouwel, A. (2020).** North Macedonia goes global: Pro-EU aspiration and anti-EU sentiment as a basis for EU-related conspiracy theories. In *Conspiracy Theories in Eastern Europe*. Routledge. 250-267 DOI: <https://doi.org/10.4324/9780429326073-17>



- Goreis, A., & Voracek, M.** (2019). A systematic review and meta-analysis of psychological research on conspiracy beliefs: Field characteristics, measurement instruments, and associations with personality traits. *Frontiers in Psychology*, 10, 205. <https://doi.org/10.3389/fpsyg.2019.00205>
- Hofstadter, R.** (1964). *The paranoid style in American politics*. New York, NY: Vintage
- Imhoff, R., & Lamberty, P. K.** (2017). Too special to be duped: Need for uniqueness motivates conspiracy beliefs. *European journal of social psychology*, 47(6), 724-734. DOI: <https://doi.org/10.1002/ejsp.2265>
- Jolley, D., & Paterson, J. L.** (2020). Pylons ablaze: Examining the role of 5G COVID-19 conspiracy beliefs and support for violence. *British journal of social psychology*, 59(3), 628-640. DOI: <https://doi.org/10.1111/bjso.12394>
- Kahneman, D.** (2011). *Thinking, fast and slow*. New York, NY: Macmillan.
- Lantian, A., Bagneux, V., Delouvé, S., & Gauvrit, N.** (2020). Maybe a Free Thinker but not a Critical One: High Conspiracy Belief is Associated With low Critical *Thinking Ability*. *Applied Cognitive Psychology*. DOI: <https://doi.org/10.1002/acp.3790>
- Lantian, A., Wood, M., & Gjoneska, B.** (2020). Personality traits, cognitive styles and worldviews associated with beliefs in conspiracy theories. *Routledge Handbook of Conspiracy Theories*, 155-167. DOI: https://doi.org/10.4324/9780429452734-2_1
- Roizenbeek, J., van der Linden, S., & Nygren, T.** (2020). Prebunking interventions based on “inoculation” theory can reduce susceptibility to misinformation across cultures. *Harvard Kennedy School (HKS) Misinformation Review*. DOI: <https://doi.org/10.37016//mr-2020-008>
- Swami, V., Pietschnig, J., Stieger, S., & Voracek, M.** (2011). Alien psychology: Associations between extraterrestrial beliefs and paranormal ideation, superstitious beliefs, schizotypy, and the Big Five personality factors. *Applied Cognitive Psychology*, 25(4), 647-653. DOI: <https://doi.org/10.1002/acp.1736>
- Swami, V., Weis, L., Lay, A., Barron, D., & Furnham, A.** (2016). Associations between belief in conspiracy theories and the maladaptive personality traits of the personality inventory for DSM-5. *Psychiatry Research*, 236, 86-90. DOI: <https://doi.org/10.1016/j.psychres.2015.12.027>
- Swami, V., Voracek, M., Stieger, S., Tran, U. S., & Furnham, A.** (2014). *Analytic thinking reduces belief in conspiracy theories*. *Cognition*, 133(3), 572-585. DOI: <https://doi.org/10.1016/j.cognition.2014.08.006>
- Uscinski, J. E., Enders, A. M., Klofstad, C. A., Seelig, M. I., Funchion, J. R., Everett, C., Wuchty, S., Premaratne, K., & Murthi, M. N.** (2020). Why do people believe COVID-19 conspiracy theories? *Harvard Kennedy School Misinformation Review*, 1(3). DOI: <https://doi.org/10.37016/mr-2020-015>
- Van der Linden, S., Roizenbeek, J., & Compton, J.** (2020). Inoculating Against Fake News About COVID-19. *Frontiers in Psychology*, 11, 2928. DOI: <https://doi.org/10.3389/fpsyg.2020.566790>
- Van Prooijen, J. W., Douglas, K. M., & De Inocencio, C.** (2018). Connecting the dots: Illusory pattern perception predicts belief in conspiracies and the supernatural. *European journal of social psychology*, 48(3), 320-335. <https://doi.org/10.1002/ejsp.2331>
- Van Prooijen, J. W., Krouwel, A. P., & Pollet, T. V.** (2015). Political extremism predicts belief in conspiracy theories. *Social Psychological and Personality Science*, 6(5), 570-578. DOI: <https://doi.org/10.1177/1948550614567356>
- Wood, M. J., Douglas, K. M., & Sutton, R. M.** (2012). Dead and alive: Beliefs in contradictory conspiracy theories. *Social psychological and personality science*, 3(6), 767-773. DOI: <https://doi.org/10.1177/1948550611434786>



2. ARTIKUJT GAZETARESKË

- Argentino, M.A. (2021).** QAnon and the storm of the U.S. Capitol: The offline effect of online conspiracy theories. *The Conversation*. <https://theconversation.com/qanon-and-the-storm-of-the-u-s-capitol-the-offline-effect-of-online-conspiracy-theories-152815>
- CommunicateHealth. (2020).** The Truth Sandwich: A Better Way to Mythbust. *Medium*. <https://medium.com/wehearthehealthliteracy/the-truth-sandwich-a-better-way-to-mythbust-8021d2cf8730>
- Culliford, E. (2021).** Facebook to label all posts about COVID-19 vaccines. *Reuters*. <https://www.reuters.com/article/us-health-coronavirus-facebook/facebook-to-label-all-posts-about-covid-19-vaccines-idUSKBN2B70NJ?il=0>
- Gilbert, D. (2021).** How QAnon Is Tearing Families Apart. *Vice*. <https://www.vice.com/en/article/dy8ayx/how-qanon-is-tearing-families-apart>
- Lewis, T. (2020).** Eight Persistent COVID-19 Myths and Why People Believe Them. *Scientific American*. <https://www.scientificamerican.com/article/eight-persistent-covid-19-myths-and-why-people-believe-them/>
- Merlan, A. (2020).** The Conspiracy Singularity Has Arrived. *Vice*. <https://www.vice.com/en/article/v7gz53/the-conspiracy-singularity-has-arrived>
- Reuters Staff. (2020).** Fact check: COVID-19 vaccine labels would not microchip or track individuals, but serve logistical purpose. *Reuters*. <https://www.reuters.com/article/uk-factcheck-microchip-not-injected-covi-idUSKBN2801TM>
- Uscinski, J. E. (2013).** Beliefs in conspiracies tend to accord with political attitudes, making it unlikely that any one conspiracy theory will be embraced by the country. *LSE American Politics and Policy (USAPP) Blog*. http://eprints.lse.ac.uk/57160/1/blogs.lse.ac.uk-Beliefs_in_conspiracies_tend_to_accord_with_political_attitudes_making_it_unlikely_that_any_one_consp.pdf

3. RAPORTE TË ORGANIZATAVE

- Smith, R., Cubbon, S., & Wardle, C. (2020).** Under the surface: Covid-19 vaccine narratives, misinformation & data deficits on social media. *USA: First Draft News*. Dostapen na: https://firstdraftnews.org/wp-content/uploads/2020/11/FirstDraft_Underthesurface_Fullreport_Final.pdf?x86275
- Wardle, C., & Derakhshan, H. (2017).** Information disorder: Toward an interdisciplinary framework for research and policy making. *Council of Europe report*, 27, 1-107. Dostapen na: <https://rm.coe.int/information-disorder-report-version-august-2018/16808c9c77>
- Bieber, F., Prelec, T., Jović, D., & Nechev, Z. (2020).** The suspicious virus: Conspiracies and COVID-19 in the Balkans. *The Balkans in Europe Policy Advisory Group report*. Dostapen na: <https://biepag.eu/wp-content/uploads/2020/12/Conspiracies-and-COVID19-in-the-Balkan-English.pdf>
- Hajdu, D., Milo, D., Klingová, K., & Sawiris, M. (2020).** GLOBSEC Trends 2020: Central Europe, Eastern Europe and Western Balkans at the times of pandemic. *GLOBSEC Policy Institute report*. Dostapen na: https://www.globsec.org/wp-content/uploads/2020/12/GLOBSEC-Trends-2020_read-version.pdf
- Reçica, Jovevska Gjorgjeviq, A. (2021)** Pamja e Kuvendit: Rezultatet nga një studim në terren për perceptimin e qytetarëve rreth punës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (17 shkurt - 10 mars 2021). *Raport mbi Programin e Mbështetjes Parlamentare nga Instituti Kombëtar Demokratik, Qendra për Menaxhimin e Ndryshimit dhe Instituti Societas Civilis për Demokraci*. Në dispozicion në: https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2021/04/MKDWEB_A4_Terenska_anketa_mart_2021-2.pdf
- Petkovski L. (2020).** Pandemia apo infodemia? Teoritë e mendimit kritik dhe konspiracionit gjatë një pandemie. *Raport nga Fondacioni për Shoqëri dhe Internetit "Metamorfozis" dhe Qendra për strategji evropiane "Eurothink"*. Në dispozicion në: <https://crithink.mk/wp-content/uploads/2020/12/final-pandemija-ili-infodemija.pdf>



4. UEB-FAQET

Faqja zyrtare e Komisionit Evropian për identifikimin e teorive të konspiracionit: https://ec.europa.eu/info/live-work-travel-eu/coronavirus-response/fighting-disinformation/identifying-conspiracy-theories_en

Faqja zyrtare e Rrjetit Evropian të Ekspertëve për Analiza Krahasuese të Teorive të Konspiracionit: <https://conspiracytheories.eu/>

Ueb-faqja e lojërave interaktive për mbrojtje nga dezinformatat e lidhura me Kovid-19: <https://www.goviralgame.com/en>



